


AL

MNE

UDHËZIME TË DETAJUARA PËR PËRDORIMIN E MAKINËS LARËSE

gorenje



Sot, jeta është e ndërlikuar. Le ta bëjmë më të thjeshtë kujdesin për larjen e rrobave! Makina juaj e re larëse **WaveActive (Vala aktive)** përdor teknologji inovatore dhe arritjet më të fundit për kujdesin e larjes së rrobave, që t'ju ndihmojë të thjeshtoni punët e përditshme të shtëpisë. Teknologjia **WaveActive** ofron kujdesin më të butë për çdo veshje, me zhubrosje minimale. Në të njëjtën kohë, makina juaj larëse do të jetë e pranueshme për mjedisin, për shkak të përdorimit shumë efikas të energjisë, ujit dhe detergjentit.

Kjo makinë larëse është e projektuar vetëm për përdorim shtëpiak. Ju lutemi të mos e përdorni për asnjë rrobë të etiketuar si të papërshtatshme për larje në makinë.

Simbolet në vijim përdoren gjatë gjithë manualit dhe kanë kuptimet si vijon:



Informacion, këshillë ose rekomandim



Kujdes – rrezik i përgjithshëm



Kujdes – rrezik nga goditja elektrike



Kujdes – rrezik nga sipërfaqja e nxehtë



Kujdes – rrezik nga zjarri



Është e rëndësishme që të lexoni me kujdes udhëzimet.

PËRMBAJTJA

4 MASA PARAPRAKE TË SIGURISË 10 PËRSHKRIMI I MAKINËS LARËSE 11 Specifikimet teknike 12 Njësia e kontrollit	HYRJE
14 INSTALIMI DHE LIDHJA 14 Heqja e shufrave bllokuese 15 Lëvizja dhe transporti pas instalimit 16 Zgjedhja e ambientit 16 Rregullimi i këmbëve të makinës larëse 17 Vendosja e makinës larëse 19 Lidhja me ujësjellësin 21 Aqua - stop (ndaluesi i ujit) 21 Total aqua - stop (ndaluesi i plotë i ujit) 22 Lidhja dhe siguri i tubit shkarkues të ujit 24 Lidhja e pajisjes elektroshtëpiake me rrjetin elektrik 25 PËRPARA PËRDORIMIT TË PAJISJES ELEKTROSHTËPIAKE PËR HERË TË PARË	PËRGATITJA E MAKINËS LARËSE PËRPARA PËRDORIMIT TË PARË
26 PROCESI I LARJES, HAP PAS HAPI (1-7) 26 Hapi 1: Merrni parasysh etiketat e rrobave 27 Hapi 2: Përgatitja e procesit të larjes 30 Hapi 3: Zgjedhja e programit të larjes 34 Hapi 4: Zgjedhja e cilësimeve 40 Hapi 5: Zgjedhja e funksioneve shtesë 44 Hapi 6: Fillimi i programit të larjes 45 Hapi 7: Ndryshimi i programit të larjes ose anulimi manual (fizik) 46 Hapi 8: Përfundimi i programit të larjes 47 NDËRPRERJET DHE NDRYSHIMI I PROGRAMIT 51 MIRËMBAJTJA DHE PASTRIMI 51 Pastrimi i kutisë shpërndarëse 52 Pastrimi i tubit të furnizimit me ujë, zgavrës të shpërndarjes së detergjentit dhe garnicionit prej gome të derës 53 Pastrimi i filtrit të pompës 54 Pastrimi i pjesës së jashtme të makinës larëse	HAPAT E PROCESIT TË LARJES
51 MIRËMBAJTJA DHE PASTRIMI 51 Pastrimi i kutisë shpërndarëse 52 Pastrimi i tubit të furnizimit me ujë, zgavrës të shpërndarjes së detergjentit dhe garnicionit prej gome të derës 53 Pastrimi i filtrit të pompës 54 Pastrimi i pjesës së jashtme të makinës larëse	MAKINA LARËSE PASTRIMI DHE MIRËMBAJTJA
55 ZGJIDHJA E PROBLEMEVE 55 Çfarë të bëjmë ...? 56 Tabela e zgjidhjes së problemeve dhe gabimeve 60 Riparimi/shërbimi 61 REKOMANDIME PËR LARJEN DHE PËRDORIMIN EKONOMIK TË MAKINËS SUAJ LARËSE 65 Këshilla për heqjen e njollave 67 HEDHJA 68 KOHËZGJATJA E PROGRAMIT DHE TABELA E NORMËS SË RROTULLIMEVE	ZGJIDHJA E PROBLEMEVE/ DEFЕКТЕВЕ
61 REKOMANDIME PËR LARJEN DHE PËRDORIMIN EKONOMIK TË MAKINËS SUAJ LARËSE 65 Këshilla për heqjen e njollave 67 HEDHJA 68 KOHËZGJATJA E PROGRAMIT DHE TABELA E NORMËS SË RROTULLIMEVE	TË NDRYSHME

MASA PARAPRAKE TË SIGURISË



Përpara përdorimit të makinës larëse, lexojini me kujdes udhëzimet e përdorimit.

Ju lutemi, mos e përdorni makinën larëse pa i lexuar dhe kuptuar këto udhëzime për përdorimin fillestar.

Këto udhëzime për përdorimin e makinës larëse jepen me lloje ose modele të ndryshme të makinave larëse. Prandaj, ato mund të përfshijnë përshkrime të parametrave ose pajisjeve të cilat nuk janë të disponueshme në makinën tuaj larëse.

Mosrespektimi i udhëzimeve të përdorimit ose përdorimi i papërshtatshëm i makinës larëse mund të rezultojë në dëmtim të rrobave, të pajisjes elektroshtëpiake ose në dëmtim të përdoruesit. Mbajeni manualin udhëzues të përdorshëm, afër makinës larëse.

Udhëzimet e përdorimit janë të disponueshme në faqen tonë të internetit www.gorenje.com.

Makina juaj larëse është e destinuar vetëm për përdorim familjar. Në qoftë se makina larëse përdoret për qëllime profesionale apo fitimprurëse ose qëllime që tejkalojnë përdorimin normal të një familjeje apo në rast se makina larëse përdoret nga një person i cili nuk është konsumatori, periudha e garancisë do të jetë e barabartë me periudhën më të shkurtër të garancisë së kërkuar nga legjislacioni përkatës.

Zbatoni udhëzimet për instalimin e rregullt të makinës larëse Gorenje dhe për lidhjen me rrjetin elektrik dhe me ujësjellësin (shikoni kapitullin »INSTALIMI DHE LIDHJA«).

Lidhja me ujin dhe me furnizimin me energji duhet të kryhet nga një teknik ose ekspert i trajnuar siç duhet.

Çdo riparim dhe mirëmbajtje që ka të bëjë me sigurinë ose performancën duhet të bëhet nga ekspertë të trajnuar.

Për të shmangur rrezikun, **një kabëll elektrik i dëmtuar** mund të zëvendësohet vetëm nga prodhuesi, një teknik shërbimi ose një person i autorizuar.

Përpara se të lidhni makinën larëse me rrjetin elektrik, prisni të paktën 2 orë derisa të arrijë temperaturën e ambientit.

Në rast defekti, përdorni vetëm pjesë këmbimi të miratuara nga prodhuesit e autorizuar.

Në rast të lidhjes së parregullt të makinës larëse, përdorimit të parregullt ose shërbimit nga një person i paautorizuar, koston e çdo dëmtimi duhet ta mbajë përdoruesi, pasi ky lloj dëmtimi nuk do të mbulohet nga garancia.

Makina larëse nuk mund të lidhet me rrjetin elektrik duke përdorur kabëll zgjatues.

Mos e lidhni makinën larëse në rrjetin elektrik duke përdorur pajisje të jashtme ndezëse/fikëse, të tillë si programues kohorapo ta lidhni me një rrjet elektrik që ndizet dhe fiket rregullisht nga furnizuesi me energji.

Mos e lidhni makinën larëse në një prizë elektrike të destinuar për një makinë elektrike roje ose tharëse flokësh.

Mos e instaloni makinën larëse në një ambient ku temperatura mund të bjerë nën 5°C, pasi pjesët e makinës larëse mund të dëmtohen në rast të ngrirjes së ujit.

Vendoseni makinën larëse në një bazament të niveluar dhe të qëndrueshëm (betoni).

Në qoftë se makina larëse vendoset në një bazament të qëndrueshëm të ngritur, makina larëse duhet të sigurohet më shumë kundërpërmbysjes.

Përpara përdorimit të makinës larëse për herë të parë, hiqini shufrat bllokuese, pasi ndezja e një makine larëse të bllokuar mund të rezultojë në dëmtime serioze (shikoni kapitullin »INSTALIMI DHE LIDHJA/Heqja e shufrave bllokuese«). Në rast të një dëmtimi të tillë garancia do të jetë e pavlefshme.

Për të lidhur makinën larëse me ujësjellësin, sigurohuni që të përdorni tubin dhe guarnicionet e dhëna për furnizimin me ujë. Presioni i ujit duhet të jetë ndërmjet 0.05 dhe 0.8 MPa (0.5–8 bar).

Për furnizimin me ujë përdorni gjithmonë një tub të ri, për të lidhur makinën larëse me ujësjellësin; mos përdorni përsëri një tub të vjetër për furnizimin me ujë.

Fundi i tubit të shkarkimit të ujit duhet të arrijë në linjën e shkarkimit të ujit.

Përpara se të fillojë cikli i larjes, shtypeni derën në vendin e treguar, derisa të shkojë në vend. Dera nuk mund të hapet gjatë operimit të makinës larëse.

Përpara larjes së parë, ne rekomandojmë që të hiqni të gjitha papastërtitë nga kazani i makinës larëse, duke përdorur programin Cotton 90°C (Pambuku 90°C) (shikoni TABELËN E PROGRAMEVE).

Pas ciklit të larjes, mbylleni rubinetin e ujit dhe hiqeni prizën e makinës larëse nga priza elektrike.

Pastrojeni filtrin i pompës sa herë që në njësinë e ekranit shfaqet simboli .

Makinën larëse përdoreni vetëm për larjen e rrobave, siç përshkruhet në manualin e udhëzimeve. Makina nuk është e destinuar për pastrim të thatë (kimik).

Përdorni vetëm agjentë për larje me makinë dhe për ruajtjen e rrobave. Ne nuk do të jemi përgjegjës për asnjë dëmtim ose çngjyrosje të guarnicioneve dhe të pjesëve plastike, të cilat rezultojnë nga përdorimi i parregullt i agjentëve zbardhues ose ngjyrosës.

Për të hequr smërçin, përdorni vetëm agjentë për heqje smërçi me mbrojtje shtesë anti-gërryerjes. (Përdorni vetëm agjentë jo-gërryes për heqje smërçi.) Zbatoni udhëzimet e prodhuesit. Përfundojeni procesin e heqjes së smërçit me disa cikle shpërlarjeje ose duke vënë në funksionim programin e Steril tub (Sterilizim kazani/Programi i vetëpastrimit), në mënyrë që të hiqni të gjitha mbetjet acide (p.sh. uthull, etj.).

 Mos përdorni detergjentë të cilët përmbajnë tretës, pasi kjo mund të çojë në çlirimin e gazrave helmues, në dëmtimin e makinës larëse dhe në rrezik zjarri dhe shpërthimi.

Gjatë programit të larjes nuk çlirohet asnjë joni argjendit.

Makina larëse nuk është e destinuar për t'u përdorur nga persona (përfshirë fëmijët) me dëmtime fizike ose mendore aponga persona me mungesë të përvojës dhe njohurive. Këta persona duhet të udhëzohen nga personi përgjegjës për sigurinë e tyre, për përdorimin e makinës larëse.

Garancia nuk i mbulon pjesët e konsumueshme, ndryshimet e lehta në ngjyrë, zhurmën e rritur e cila rezulton nga mosha e pajisjes dhe që nuk ndikon në funksionalitetin e pajisjes elektroshtëpiake, sidhe defektet estetike të pjesëve përbërëse, të cilat nuk ndikojnë në funksionalitetin dhe në sigurinë e pajisjes.

SIGURIA E FËMIJËVE

Përpara mbylljes të derës së makinës larëse dhe fillimit të programit, sigurohuni që në kazan të mos ketë asgjë përveç rrobave (p.sh. nëse një fëmijë ka hipur në kazanin e makinës larëse dhe e ka mbyllur derën nga brenda).

Mbajeni detergjentin dhe zbutësin larg prekjes së fëmijëve.

Aktivizojeni bllokimin për fëmijët. Shikoni kapitullin »ZGJEDHJA E MODALITETEVE/Bllokimi për fëmijët«.

Mos i lejoni fëmijët më të vegjël se tre vjeç të shikojnë pranë pajisjes elektroshtëpiake, në qoftë se nuk janë nën mbikëqyrje të vazhdueshme.

Makina larëse është prodhuar në përputhje me të gjitha standardet përkatëse të sigurisë.

Kjo makinë larëse mund të përdoret nga fëmijët e moshës 8 vjeç e lart dhe nga personat me aftësi të reduktuara fizike, shqisore ose mendore ose me mungesë të përvojës dhe njohurive, por vetëm nëse mbikëqyren gjatë përdorimit të makinës larëse, nëse atyre ju janë dhënë udhëzimet përkatëse në lidhje me përdorimin e sigurt të makinës larëse dhe nëse i kuptojnë rreziqet e përdorimit të parregullt. Sigurohuni që fëmijët të mos luajnë me pajisjen elektroshtëpiake. Fëmijët nuk duhet të pastrojnë makinën larëse apo të kryejnë detyra të mirëmbajtjes pa mbikëqyrje.

RREZIKU NGA SIPËRFAQJA E NXEHTË

Në temperaturat më të larta të larjes, xhami i derës do të nxehet. Kini kujdes që të shmangni djegiet. Sigurohuni që fëmijët të mos luajnë pranë xhamit të derës.

MBROJTJA NGA TEJMBUSHJA ME UJË (ME MAKINËN LARËSE TË NDEZUR)

Në qoftë se niveli i ujit në pajisje rritet mbi nivelin normal, atëherë do të aktivizohet mbrojtja ngatejkalimi i nivelit të ujit. Ajo do të mbyllë furnizimin me ujë dhe do të fillojë të nxjerrë ujin jashtë. Programi do të ndërpritet dhe do të raportohet një gabim (shikoni TABELËN PËR ZGJIDHJEN E PROBLEMEVE).


TRANSPORTI PAS INSTALIMIT

Nëse keni ndërmend ta lëvizni makinën larëse pasi të jetë instaluar, atëherë ajo duhet të bllokohet duke vendosur të paktën një shufër bllokuese (shikoni kapitullin »INSTALIMI DHE LIDHJA/Lëvizja dhe transporti«). Përpara se të vendosni shufrat bllokuese, shkëputeni makinën larëse nga rrjeti elektrik!

PËRSHKRIMI I MAKINËS LARËSE


PJESA E PËRPARME

1. Njësia e kontrollit
2. Butoni i fillimi/ndalimi
3. Çelësi për zgjedhjen e programit
4. Butoni i ndezjes/fikjes/rifillimit
5. Kutia shpërndarëse
6. Dera
7. Pllaka e të dhënave
8. Filtri i pompës



PJESA E PASME

1. Tubi i furnizimit me ujë
2. Kablli elektrik
3. Tubi i shkarkimit të ujit
4. Këmbët e rregullueshme



SPECIFIKIMET TEKNIKE

(NË VARËSI TË MODELIT)

Pllaka e të dhënave me informacionin bazë për makinën larëse është e vendosur në murin e përparmë të hapësirës së derës së makinës larëse (shikoni kapitullin »PËRSHKRIMI I MAKINËS LARËSE«).

Ngarkesa maksimale	Shikoni pllakën e të dhënave			
Gjerësia	600 mm	600 mm	600 mm	600 mm
Lartësia	850 mm	850 mm	850 mm	850 mm
Gjatësia e makinës larëse (a)	430 mm	465 mm	545 mm	610 mm
Gjatësia me derë të mbyllur	462 mm	495 mm	577 mm	640 mm
Gjatësia me derë të hapur (b)	947 mm	980 mm	1062 mm	1125 mm
Pesha e makinës larëse	X kg (në varësi të modelit)			
Tensioni i përshtatshëm	Shikoni pllakën e të dhënave			
Fuqia nominale	Shikoni pllakën e të dhënave			
Lidhja	Shikoni pllakën e të dhënave			
Presioni i ujit	Shikoni pllakën e të dhënave			
Rryma	Shikoni pllakën e të dhënave			
Frekuenca	Shikoni pllakën e të dhënave			

Pllaka e të dhënave

gorenje

TYPE: PS15/XXXXX MODEL: XXXXXX.X

Art.No.: XXXXXX Ser.No.: XXXXXXXX


220-240 V ~ XX Hz XX A Pmax.: XXXX W

XXXX W XXXX/min X kg 0,05-0,8 MPa

IPX4

MADE IN SLOVENIA

NJËSIA E KONTROLLIT



1 BUTONI I NDEZJES/ FIKJES/RIFILLIMIT

Përdoreni këtë buton për të ndezur dhe fikur makinën larëse dhe për të rifilluar programin e larjes.

Butoni ndizet kur makina larëse është e ndezur.


2 ÇELËSI PËR ZGJEDHJEN E PROGRAMIT

2a Drita pas programit larës të përzgjedhur është e ndezur.

3 BUTONI I FILLIMI/ NDALIMIT

Përdoreni këtë buton për të filluar ose ndaluar një program.

Pasi të fillojë ose gjatë ndalimit, sfondi i butonit do të pulsojë; kur programi të ketë filluar dhe në vazhdim, ai do të ndriçojë vazhdimisht.



4 MODALITETI I LARJES

4a **POWERCARE**

4b **TIMECARE** (KUJDESI PËR KOHËN)

5 DOSE AID

Informacion për sasinë e rekomanduar të detergjentit pluhur dhe të lëngshëm, në përputhje me cilësimet e përzgjedhura dhe me sasinë e rrobave që do të lahen në kazan.

6 GREENGUIDE

Informacion për konsumin e ujit dhe të energjisë, në përputhje me cilësimet e larjes së përzgjedhur.

7 PREWASH (PARALARJA)

8 Simboli ndriçon
PASTRIMI I FILTRIT TË POMPËS

9 TEMP. (TEMPERATURA E LARJES)

Opsionet e vendosjes së temperaturës

10 SPIN (RROTULLIMET/ CENTRIFUGA)

(NORMA E RROTULLIMEVE) /SHKARKIMI /NDALIMI I POMPËS

Opsion për të vendosur normën e rrotullimeve.

11 START DELAY (FILLIMI ME VONESË)

Opsion për të vendosur fillimin me vonesë

12 Simboli ndriçon BLOKIMI PËR FËMIJËT

Shtypini pozicionet 11+13 dhe mbajini të shtypur për 3 sekonda.

13 WATER+ (UJË+) (NIVEL I LARTË I UJIT)


Opsion për të vendosur nivelin e lartësisë së ujit (2 nivele)

INSTALIMI DHE LIDHJA

⚠ Hiqeni të gjithë paketimin. Kur të hiqni paketimin, sigurohuni që të mos e dëmtoni pajisjen elektroshtëpiake me objekte të mprehta.

HEQJA E SHUFRAVE BLOKUESE

⚠ Përpara përdorimit të pajisjes elektroshtëpiake për herë të parë, shufrat e transportit duhet të hiqen. Një makinë larëse e bllokuar mund të dëmtohet kur ndizet për herë të parë. Në rast të një dëmtimi të tillë, garancia do të jetë e pavlefshme!



LËVIZJA DHE TRANSPORTI PAS INSTALIMIT

☼ Në qoftëse dëshironi të lëvizni makinën larëse pasi të jetë instaluar, pjesët këndore dhe të paktën një shufër bllokuese duhet të ri-instalohen për të mos lejuar dëmtimin e makinës larëse nga dridhjet gjatë transportit (shikoni kapitullin »INSTALIMI DHE LIDHJA/Heqja e shufravebllokuese«). Në qoftëse i keni humbur pjesët këndore dhe shufrat bllokuese, ato mund të porositen nga prodhuesi.

⚠ Pas transportit, makina larëse duhet të lihet të qëndrojë palëvizur për të paktën dy orë përpara se të lidhet me rrjetin elektrik, në mënyrë që të arrijë temperaturën e ambientit. Pajisja elektroshtëpiake duhet të instalohet dhe të lidhet nga një teknik i trajnuar.

⚠ Para se të lidhni makinën larëse, lexoni me kujdes udhëzimet e përdorimit. Riparimi ose çfarëdopretendim për garanci që rezulton nga lidhja ose përdorimi i parregullt i makinës larëse nuk do të mbulohet nga garancia.


ZGJEDHJA E AMBIENTIT

☼ DysHEMEJA mbi të cilën vendoset makina larëse duhet të ketë bazament betoni. Duhet të jetë e pastër dhe e thatë; përndryshe, makina larëse mund të rrëshqasë. Gjithashtu, pastroni sipërfaqen e poshtme të këmbëve të rregullueshme.

☼ Makina larëse duhet të qëndrojë e niveluar dhe e palëvizshme në një bazament të fortë.

RREGULLIMI I KËMBËVE TË MAKINËS LARËSE

Përdorni një nivelues me ujë dhe çelësa nr.32 (për këmbët) dhe 17 (për dadot).



1 Nivelojeni makinën larëse në drejtim gjatësor dhe tërthor duke rrotulluar këmbët e rregullueshme.

2 Pas rregullimit të lartësisë së këmbëve, shtrëngojeni me forcë dadot bllokuese (kondradadot) me një çelës nr. 17, duke e rrotulluar drejt fundit të makinës larëse ↑ (shikoni figurën).

☼ Nivelimi i parregullt i makinës larëse nëpërmjet këmbëve të rregullueshme, mund të shkaktojë dridhje, që pajisjatë rrëshkasë nëpër dhomë dhe të funksionojë me zhurmë të madhe. Nivelimi i parregullt i makinës larëse nuk është subjekt i garancisë.

☼ Në disa raste, gjatë përdorimit të pajisjes elektroshtëpiake mund të shfaqet zhurmë e lartë ose e pazakonshme; kryesisht këto janë rezultat i instalimit të parregullt.


VENDOSJA E MAKINËS LARËSE

Nëse keni edhe tharëse rrobash Gorenje të përmasave korresponduese (të njëjta), ajo mund të vendoset mbi makinën larëse Gorenje (në këtë rast duhet të përdoren këmbët me vakum) ose pranë saj (figurat 1 dhe 3).



Në qoftëse makina juaj larëse Gorenje është më e vogël (gjatësia minimale 545 mm) se tharësja juaj Gorenje, atëherë duhet të blihet mbajtësja e tharëses (figura 2). Është e domosdoshme të përdoren këmbët me vakum! Pajisjet shtesë (mbajtësja e tharësit (a) dhe këmbët me vakuum (b)) janë të disponueshme për t'u blerë në njësitë e shërbimit.

Sipërfaqja në të cilën vendoset pajisja elektroshtëpiake duhet të jetë e pastër dhe e niveluar.

Makina larëse Gorenje mbi të cilën mendoni të vendosni tharësen Gorenje duhet të mbajë peshën e tharëses Gorenje (shikoni kapitullin »PËRSHKRIMI I MAKINËS LARËSE/Informacion teknik«).



Hapësirat për instalimin e makinës larëse




☼ Makina larëse nuk duhet të jetë në kontakt me murin ose me mobiljet pranë. Për funksionim optimal të makinës larëse, ne rekomandojmë respektimin e hapësirave nga muret, siç është paraqitur në figurë.

Në rast të pamundësisë për të ruajtur hapësirat minimale të nevojshme, nuk mund të sigurohet funksionimi i sigurt dhe i rregullt i makinës larëse. Përveç kështre, mund të ndodhë edhe mbinxehja e saj (figurat 1 dhe 2).

☼ Instalimi i makinës larëse poshtë bangos së kuzhinës nuk rekomandohet.

Hapja e derës së makinës larëse (pamja nga lart)



Shikoni kapitullin »PËRSHKRIMI I MAKINËS LARËSE/Informacion teknik«.


a = Gjatësia e makinës larëse

b = Gjatësia me derë të hapur

⚠ Përpara se të lidhni makinën larëse me rrjetin elektrik, prisni të paktën 2 orë derisa të arrijë temperaturën e ambientit.

LIDHJA ME UJËSJELLËSIN

Lidhni tubin me rubinetin e ujit duke e vidhosur në filetim.



☼ Në rast se makina juaj larëse ka lidhje për ujë të ngrohtë dhe të ftohtë, por ju doni ta lidhni atë vetëm me furnizimin me ujë të ftohtë, mos e instaloni tubin e ujit të ngrohtë dhe mbylleni lidhjen me ujin e ngrohtë në pjesën e pasme të makinës larëse me tapën e dhënë.

☼ Në qoftë se makina juaj larëse karakterizohet nga lidhja me ujë të nxehtë dhe të ftohtë me pajisjen e plotë aquastop (opsioni B) dhe ju dëshironi të lidhni vetëm furnizimin me ujë të ftohtë, atëherë mbylleni tubin e ujit të nxehtë me një tapë të përshtatshme 3/4", e cila nuk është dhënë me pajisjen elektroshtëpiake. Tapa 3/4" disponohet në dyqanet e specializuara të materialeve hidraulike.

☼ Për funksionim normal të makinës larëse, presioni në rrjetin e ujit duhet të jetë midis 0.05 dhe 0.8 MPa (0.5 - 8 bar). Presioni minimal dinamik i ujit mund të përcaktohet duke matur rrjedhën e ujit. Në 15 sekonda, nga një rubinet i hapur plotësisht duhet të rrjedhin 3 litra ujë.


☞ Në qoftëse modeli juaj ka lidhje për ujë të nxehtë dhe të ftohtë, atëherë lidheni njërintub me linjën e ujit të ftohtë (dadoja me krahë blu ose shenja blu në tub) dhe tjetrën me linjën e ujit të nxehtë (dadoja me krahë të kuq ose shenja e kuqe në tub), siç tregohet në pjesën e pasme të makinës larëse. Lidhjet janë etiketuar me shkronjat C dhe H (C-cold = e ftohtë, H-hot = e nxehtë). Uji i ngrohtë (përzierja e ujit të nxehtë dhe të ftohtë) shtohet vetëm për programet në 40 °C ose më të larta.

☞ Shtrengojeni me dorë tubin e furnizimit me ujë, me një forcë të mjaftueshme që tubi të bashkohet mirë (maksimumi 2 Nm). Pas lidhjes së tubit, bashkimi duhet të kontrollohet për ndonjë rrjedhje. Mos përdorni pinca ose mjete të ngjashme gjatë lidhjes së tubit, pasi kjo mund të dëmtojë filetot e dados.

☞ Përdorni vetëm tubin e furnizimit me ujë të dhënë me pajisjen. Mos përdorni asnjë tub të përdorur ose tjetër.


AQUA - STOP (NDALUESI I UJIT) (VETËM NË DISA MODELE)

Në qoftë se dëmtohet një tub i brendshëm, aktivizohet një sistem mbyllës i cilindërpret furnizimin me ujë të makinës larëse. Në raste të tilla, xhami i kontrollit (a) do të bëhet i kuq. Zëvendësojeni tubin e furnizimit me ujë.



TOTAL AQUA - STOP (NDALUESI I PLOTË I UJIT) (VETËM NË DISA MODELE)

Në qoftë se dëmtohet një tub i brendshëm dhe në qoftë se në fund të makinës larëse ka ujë, do të aktivizohet një sistem mbyllës, i cili do të ndërpresë furnizimin me ujë të makinës larëse. Në raste të tilla, do të ndalohet procesi i larjes, do të ndërpritet furnizimi me ujë, makina larëse do të aktivizojë pompën dhe do të sinjalizojë një gabim.




⚠ Mos e zhytni në ujë tubin e furnizimit me ujë që ka sistemin Aqua stop, sepse ai përmban një valvul elektrike.

⚠ Kur të lidhni tubin e furnizimit me ujë, sigurohuni që ta lidhni në një mënyrë që të lejojë furnizimin e duhur dhe pa pengesa të ujit.


LIDHJA DHE SIGURIMI I TUBIT SHKARKUES TË UJIT

Futni tubin e shkarkimit të ujit në një lavaman, në një vaskë ose lidhjeni direkt mekanalizimet (tubin e shkarkimit me diametër prej të paktën 4 cm). Distanca vertikale nga dyshemeja deri në fund të tubit të shkarkimit duhet të jetë jo më shumë se 100 cm dhe jo më pak se 60 cm. Ai mund të lidhet në tre mënyra (A, B, C).




A Fundi i tubit shkarkues mund të vendoset mbi një lavaman ose vaskë. B Përdorni një kapëse teli përmes vrimës në bërnylit mbajtës për të lidhertubin dhe për të mos e lejuar të rrëshqasë në dysheme.

B Tubi shkarkues mund të lidhet edhe direkt me tubacionin e shkarkimit të lavamanit.



C Tubi shkarkues mund të lidhet edhe me tubacionin e shkarkimit në mur, me një mbajtëse; kjo mbajtëse duhet të instalohet siç duhet për të lejuar pastrimin.





.....

D Tubi i shkarkimit duhet të vendoset dhe të fiksohet në kapësen në pjesën e pasme të makinës larëse, siç tregohet në figurë.

⚠ Në rast se tubi i shkarkimit nuk është lidhur në mënyrën e duhur, nuk mund të sigurohet funksionimi i sigurt dhe i rregullt i makinës larëse.

LIDHJA E PAJISJES ELEKTROSHTËPIAKE ME RRJETIN ELEKTRIK



⚠ Përpara se të lidhni makinën larëse me rrjetin elektrik, prisni të paktën 2 orë derisa të arrijë temperaturën e ambientit.

Makinën larëse lidhni në një prizë me tokëzim. Pas instalimit, priza e murit duhet të jetë lehtësisht e arritshme. Priza duhet të jetë e pajisur me kontakt tokësor (në përputhje me rregulloret përkatëse).

Informacioni mbi makinën tuaj të larjes është dhënë në pllakën e të dhënave (shikoni kapitullin »PËRSHKRIMI I MAKINËS LARËSE/Informacion teknik«).

⚠ Ne rekomandojmë përdorimin e mbrojtjes ndaj tensionit të lartë, për të mbrojtur pajisjen elektroshtëpiake në rast të goditjes nga rrufeja.

⚠ Makina larëse nuk mund të lidhet me rrjetin elektrik duke përdorur kabëll zgjatues.

⚡ Mos e lidhni makinën larëse në një prizë elektrike të destinuar për një makinë elektrike roje ose tharëse flokësh.


⚡ Çdo riparim dhe mirëmbajtje që ka të bëjë me sigurinë ose performancën duhet të bëhet nga ekspertë të trajnuar.

⚡ Një kabëll elektrik i dëmtuar mund të zëvendësohet vetëm nga një person i autorizuar nga prodhuesi.


PËRPARA PËRDORIMIT TË PAJISJES ELEKTROSHTËPIAKE PËR HERË TË PARË

Sigurohuni që makina larëse është e shkëputur nga rrjeti elektrik; pastaj hapeni derën drejt vetes (figurat 1 dhe 2).

Përpara përdorimit të parë, lajeni kazanin e makinës larëse me një leckë të butë pambuku, të lagur me ujë ose përdoreni programin Cotton 90°C (Pambuku 90°C). Në kazanin e makinës larëse nuk duhet të ketë rroba; kazanin duhet të jetë bosh (figurat 3 dhe 4).




1



2



3



4

⚠ Mos përdorni asnjë agjent tretës ose pastrues që mund të dëmtojë makinën larëse (ju lutemi të zbatoni rekomandimet dhe paralajmërimet e dhëna nga prodhuesit e agjentëve të pastrimit).


PROCESI I LARJES, HAP PAS HAPI (1–7)

HAPI 1: MERRNI PARASYSH ETIKETAT E RROBAVE

Larje normale; Rroba delikate	Temperatura maksimale e larjes 95°C 	Temperatura maksimale e larjes 60°C 	Temperatura maksimale e larjes 40°C 	Temperatura maksimale e larjes 30°C 	Vetëm larje me dorë 	Mos e lani
Zbardhimi	Zbardhimi në ujë të ftohtë 			Nuk lejohet zbardhimi 		
Pastrimi kimik	Pastrim kimik me të gjithë agjentët 	Tretës karburanti R11, R113 	Pastrim kimik në kerozinë, alkool të pastër dhe në R 113 	Nuk lejohet pastrimi kimik 		
Hekurosja	Hekurosje e nxehtë, maksimumi 200°C 	Hekurosje e nxehtë, maksimumi 150°C 	Hekurosje e nxehtë, maksimumi 110°C 	Nuk lejohet hekurosja 		
Tharja	Tharje e rrafshët (vendoseni në një sipërfaqe të rrafshët) 	Tharje e njomë në tel 	Temperaturë e lartë 	Nuk thahet në tharës me ajër të nxehtë 		
		Tharje në tel 	Temperaturë e ulët 			

HAPI 2: PËRGATITJA E PROCESIT TË LARJES

1. Ndajini rrobat sipas llojit të pëlhurës, ngjyrës, ndotjes dhe temperaturës së lejuar të larjes (shikoni TABELËN E PROGRAMIT).
2. Rrobat që lëshojnë shumë fibra (qime) ose push, lajini veçmas rrobave të tjera.
3. Mbyllini kopsat dhe zinxhirët, lidhini të gjithalidhëset dhe kthejini xhepat mbrapsht; hiqini të gjitha kapëset metaliketë cilat mund të dëmtojnë rrobat dhe pjesën e brendshme të makinës larëse ose të bllokojnë tubacionin e shkarkimit.
4. Vendosini rrobat shumë të ndjeshme dhe sendet e vogla në qese me qëllim të posaçëm për larjen e rrobave.
(Qesetme qëllim të posaçëm për larjen e rrobave janë të disponueshme si aksesorë shtesë opsionalë.)



NDEZJA E MAKINËS LARËSE


Përdoreni kabllin elektrik për të lidhur makinën larëse me rrjetin elektrik dhe lidhni makinën larëse me rrjetin e furnizimit me ujë.

Shtypeni butonin (1) **NDEZJES/FIKJES/RIFILLIMIT** për të ndezur makinën larëse (figurat 1 dhe 2).

Në disa modele, kur makina larëse ndizet, edhe kazanin e makinës larëse ndizet për 5 minuta (figura 2).

Në qoftë se shtypni butonin **FILLIMI/NDALIMI** (3), drita në kazanin e makinës larëse mund të qëndrojë e ndezur gjatë përdorimit të pajisjes, si dhe pasi të përfundojë programi i larjes. (Llampa në kazanin e makinës larëse nuk është e përshtatshme për asnjë përdorim tjetër.)

☼ Llampa në kazanin e makinës larëse mund të zëvendësohet vetëm nga prodhuesi, nga një teknik shërbimi ose nga një person i autorizuar.




MBUSHJA E MAKINËS LARËSE


Hapeni derën e makinës larëse duke e tërhequr dorezën drejt vetes (figura 1).

Futini rrobat në kazan (pasi të siguroheni që kazanin është bosh) (figura 2).


Sigurohuni që ndërmjet derës dhe guarnicionit prej gome të mos kapet asnjë veshje. Mbylleni derën e makinës larëse (figura 3).



1



2



3



Mos e mbingarkoni kazanin! Shikoni TABELËN E PROGRAMIT dhe vini re që ngarkesajuaj të jetë siç tregohet në pllakën e të dhënave.

Në qoftë se makina larëse është e mbushur plot, rrobat nuk do të lahen krejtësisht.

HAPI 3: ZGJEDHJA E PROGRAMIT TË LARJES

Zgjidheni **programin** duke rrotulluar çelësin e përzgjedhjes së programit (2) në të majtë ose në të djathtë (në varësi të llojit të rrobave dhe sa shumë janë tëëndotura). Shikoni TABELËN E PROGRAMIT.

Pasi të zgjidhni programin e larjes, do të ndizet drita (2a) në njësinë e ekranit pranë programit të zgjedhur të larjes.



☼ Gjatë operimit, çelësi i përzgjedhjes së programit (2) nuk do të rrotullohet automatikisht.

☼ Programet e larjes janë programe gjithëpërfshirëse të cilat përmblendhin të gjitha fazat e larjes, duke përfshirë zbutjen dhe centrifugimin (kjo nuk vlen për Programet e pjesshme).

☼ Programet e pjesshme janë programe të pavarura. Përdorini ato kur të mendoni se nuk keni nevojë për të gjithë programin e larjes.

TABELA E PROGRAMEVE

Programi		Ngarkesa maksimale	Përshkrimi i programit
	Cotton black (Pambuk i zi) 30°C - 40°C	** (1/2)	Ky program përdoret për të larë rroba të errëta duke përdorur detergjentë me qëllim të posaçëm për rroba të zeza. Programi lan në temperatura të ulëta, me normë të butë lloqitjesh dhe centrifugimi.
	Cotton color (Pambuk me ngjyra) --; - 60°C	* MAX	Program për rroba të ndotura pak deri mesatarisht. Temperatura mund të vendoset veç e veç; për këtë arsye, zbatoni udhëzimet e treguara në veshje. Rrobat të cilat vishen direkt në mish lajini në 60°C. Rrobat më pak të ndotura do të pastrohen plotësisht në 40°C. Edhe shpejtësia e centrifugës mund të zgjidhet lirisht. Kohëzgjatja e programit dhe sasia e ujit do të rregullohen sipas sasisë së rrobave që do të lahen.
	Cotton white (Pambuk i bardhë) 40°C - 90°C	* MAX	Program për rroba normalisht ose shumë të ndotura, të bardha ose me ngjyrë. Temperatura mund të vendoset veç e veç; për këtë arsye, zbatoni udhëzimet e treguara në veshjet të cilat vishen direkt në mish. Zgjidhni 40°C në qoftë se rrobat janë vetëm pak të ndotura. Shpejtësia e centrifugës mund të vendoset sipas preferencës suaj. Kohëzgjatja e programit dhe sasia e ujit do të rregullohen sipas sasisë së rrobave që do të lahen.
	Mix (Të përziera) (Rroba të përziera/ Sintetike) --; - 60°C	3,5 kg	Programlarjejepër veshje delikate të prodhuara nga fibrat sintetike dhe të përziera ose viskoze dhe për kujdes të thjeshtë për pambukun. Zbatojini udhëzimet e treguara në veshje. Shumica e rrobave të prodhuara nga fibrat sintetike lahen në 40°C.
	Wool/Handwash (Leshi/Larja me dorë) --; - 40°C	2 kg	Program larës shumë i butë për të larë lesh, mëndafsh dhe rroba të cilat kërkojnë larje me dorë. Temperatura maksimale është 40°C. Ky program ka një cikël të shkurtër centrifugimi. Shpejtësia më e madhe e disponueshme e centrifugimit është 800 xhiro në minutë.
	Speed 20' (I shpejtë 20') 30°C	2,5 kg	Programlarjeje i shpejtë për rrobatë cilat kanë nevojë vetëm për rifreskim.
	Power 59' (Fuqia 59') 40°C	** (1/2)	Program për sasi më të vogla rrobash pak të ndotura. Programi lan me normë të butë lloqitjesh dhe centrifugimi.

* Ngarkesë maksimale (MAX)

** Gjysëm ngarkese (1/2)

/ Çfarëdolloj ngarkese (0 kg – MAX kg)

-- Larje me ujë të ftohtë

Programi	Ngarkesa maksimale	Përshkrimi i programit
 Steril tub (Sterilizim kazani/ Programi i vetëpastrimit)	0 kg	Programlarjeje që përdoret për të pastruar kazanin, për të hequr mbetjet e detergjentit dhe bakteret. Për të zgjedhur programin, rrotulloni çelësin e përzgjedhjes së programit në të majtë ose në të djathtë në pozicionin Steril tub  (Sterilizim kazani/Programi i vetëpastrimit). Funksione të tjera shtesë nuk mund të zgjidhen. Kazani duhet të jetë bosh. Mund të hidhni pak uthull vere të distiluar (rreth 2 dl) ose bikarbonat natriumi (1 lugë gjelle ose 15 g). Ne rekomandojmë që ta kryeni këtë program të paktën një herë në muaj.
 Rinse/Softening (Shpërlarja/ Zbutja) (Program i pjesshëm)	/	Për zbutjen, kollarisjen ose fryrjen e robave të lara. Ky mund të përdoret edhe si program për shpërlarje, por pa shtuar zbutës. Përfundon me një shpërlarje shtesë. Ju mund të zgjidhni edhe WATER+ (UJË+) (NIVEL I LARTË I UJIT) duke përzgjedhur funksionin shtesë.
 Spin/Drain (Rrotullimet/ Centrifuga) (Norma e rrotullimeve/ Shkarkimi) (Program i pjesshëm)	/	Përdoreni programin kur doni vetëm të centrifugonirrobat. Në qoftë se doni vetëm të nxirrni ujin jashtë nga makina larëse, shtypni butonin SPIN (RROTULLIMET/ CENTRIFUGA) (10) për të përzgjedhur (Shkarkimi) .
 Sports (Sportive) (Veshje sportive) 30°C - 40°C	3,5 kg	Veshjet sportive pak të ndotura të prodhuara nga pambuku, mikrofibrat dhe fibrat sintetike, në norma më të ulëta rrotullimesh dhe një cikël të shkurtër centrifugimi përfundimtar.
 Eco 40-60	* MAX	Cikli i larjes, ku mund të pastrohen rrobat prej pambuku të ndotura normalisht, është përcaktuar se duhet të përdoret në temperaturën 40°C ose 60°C.
 Allergy care (Kujdes ndaj alergjive) 40°C - 90°C	** (1/2)	Programlarjeje që përdoret për të larë rroba normalisht deri shumë të ndotura, që kërkojnë kujdes të veçantë, të tilla si rroba për njerëzit me lëkurë shumë të ndjeshme ose me alergji të lëkurës. Ne rekomandojmë kthimin e robave mbrapsht, pasi edhe kjo do të japë plotësisht lëkurën dhe mbetjet e tjera. Ju mund të zgjidhni edhe opsionin për të larë në temperaturën maksimale dhe në shpejtësinë maksimale të centrifugimit.

* Ngarkesë maksimale (MAX)

** Gjysëm ngarkese (1/2)

/ Çfarëdolloj ngarkese (0 kg – MAX kg)

-- Larje me ujë të ftohtë

Programi		Ngarkesa maksimale	Përshkrimi i programit
☆	Auto wash (Larje automatike) 30°C	* MAX	Programi i larjes rregullon automatikisht kohëzgjatjen e larjes kryesore dhe numrin e shpërlarjeve në varësi të sasisë së rrobave në makinë. Përdoreni për rroba jo shumë të ndotura. Nuk është e mundur vendosja e programeve shtesë.

* Ngarkesë maksimale (MAX)

** Gjysëm ngarkese (1/2)

/ Çfarëdolloj ngarkese (0 kg – MAX kg)

-- Larje me ujë të ftohtë

☼ Detegjentët në formë pluhuri apo lëngu, shtojini sipas udhëzimeve të prodhuesit, duke marrë parasysh temperaturën e larjes, programin e larjes, sa të ndotura janë rrobat dhe fortësinë e ujit.

☼ Sasia maksimale e rrobave në kg (për programin e pambukut) tregohet në pllakën e të dhënave të vendosur nën derën e makinës larëse (shikoni kapitullin »PËRSHKRIMI I MAKINËS LARËSE/ Informacion teknik«).

☼ Ngarkesa maksimale ose nominale përdoret për rrobat e përgatitura në përputhje me standardin IEC 60456.

☼ Për efekt më të mirë të larjes, ne rekomandojmë mbushjen e kazanit deri në 2/3 kur përdorni programet e pambukut.

HAPI 4: ZGJEDHJA E CILËSIMEVE

Shumica e programeve karakterizohen nga cilësimet bazë, por këto cilësime mund të ndryshohen.


Rregullojini cilësimet duke shtypur butonin e funksionit përkatës (përpara se të shtypni butonin (3) FILLIMI/NDALIMI).

Funksionet të cilat nuk mund të ndryshohen me programin e zgjedhur të larjes, janë të ndriçuara pjesërisht (të zbehta).

Disa cilësime nuk mund të përzgjidhen me disa programe. Këto cilësime nuk do të ndriçojnë dhe butoni do të pulsojë kur të shtypet (shikoni TABELËN E FUNKSIONEVE).

Përshkrimi i ndriçimit të funksioneve për programin e zgjedhur:

- **I ndriçuar** (Parametri bazë/i paracaktuar);
- **I zbehtë** (Funksionet të cilat mund të rregullohen) dhe
- **I pandriçuar** (Funksionet të cilat nuk mund të zgjidhen).



4

MODALITETI I LARJES

NORMALCARE (KUJDES NORMAL) (Parametri bazë/i paracaktuar)

□ **POWERCARE** (4a) Ky modalitet do të kursejë energji; koha e larjes do të jetë më e gjatë dhe konsumi i ujit do të jetë më i ulët.)

TIMECARE (KUJDES PËR KOHËN) (4b) (Ky modalitet do të kursejë kohë, pasi kohëzgjatja e këtij programi do të jetë më e shkurtër, por do të përdorë më shumë ujë.)


Ne rekomandojmë gjysëm ngarkesë për programin e pambukut.

Drita në butonin e zgjedhjes së modalitetit të larjes është e ndezur.

DOSE AID


Me funksionin (5) **DOSE AID**, makina larëse do të rekomandojë sasinë optimale të detergjentit pluhur ose të lëngshëm në përputhje me parametrat e përzgjedhur. Sasia e rekomanduar e detergjentit pluhur ose të lëngshëm varet nga:

- **Fortësia e ujit** (janë të disponueshme cilësimet e mëposhtme: i butë, i mesëm, i fortë. Cilësimi i paracaktuar është niveli mesatar, por përdoruesi mund ta rregullojë atë. Shikoni kapitullin »NDËRPRERJA DHE NDRYSHIMI I PROGRAMIT/Menuja e cilësimeve personale«.). Që funksioni (5) **DOSE AID** të funksionojë siç duhet, rekomandojmë vendosjen e nivelit të saktë të ashpërsisë së ujit;
- **Programi i përzgjedhur i larjes** dhe
- **Sasia e rrobave** (ngarkesa) - makina larëse e peshon sasinë e rrobave sa herë që përdoret funksioni (5) **DOSE AID**.




5

Me qëllim që karakteristika (5) **DOSE AID** të funksionojë rregullisht, duhet që paraprakisht të kryhet HAPI 2 (përgatitja e rrobave, ndezja dhe mbushja e makinës larëse) dhe HAPI 3 (përzgjedhja e programit larës).



1. Aktivizojeni funksionin duke shtypur në pozicionin (5) **DOSE AID**. Një dritë treguese do të ndriçojë poshtë shenjës (5) **DOSE AID**, kur ajo të aktivizohet.
2. Shtypeni butonin (3) **FILLIMI/NDALIMI**. Makina larëse do të fillojë peshimin e sasisë së rrobave në kazan.




3. Procesi i peshimit tregohet me pulsime alternative të dritave treguese në njësinë e ekranit.

4. Në bazë të sasië së matur të rrobave në kazan dhe të cilësimeve të tjera, sasia e rekomanduar e detergjentit pluhur ose të lëngshëm do të shfaqet në njësinë e ekranit [në ml]. Ana e majtë e njësisë së ekranit do të tregojë sasinë e rekomanduar të detergjentit të përqëndruar dhe ana e djathtë e ekranit do të tregojë sasinë e rekomanduar të detergjentit të papërqëndruar.

☼ Për të përcaktuar nëse detergjenti juaj pluhur ose i lëngshëm është apo jo i përqëndruar, kontrolloni paketimin e detergjentit tuaj.

☼ Për të kontrolluar sasinë e detergjentit të përqëndruar apo të papërqëndruar, pluhur ose të lëngshëm, shtypeni përsëri pozicionin **DOSE AID** (5).



5. Hidheni sasinë e rekomanduar të detergjentit pluhur ose të lëngshëm në depozitën e dozimit ☼. Përdoreni **treguesin e nivelit** të detergjentit pluhur ose të lëngshëm për dozim të saktë (shikoni kapitullin »REKOMANDIME PËR LARJEN DHE PËRDORIMIN EKONOMIK TË MAKINËS SUAJ LARËSE«).

Për të filluar programin e larjes, shtypeni butonin (3) **FILLIMI/NDALIMI**.

9


☐ **TEMP.** (TEMPERATURA E LARJES)

Ndryshon temperaturën për programin e përzgjedhur.

Secili program ka një temperaturë të paracaktuar e cila mund të ndryshohet duke shtypur pozicionin (9) ☐ **TEMP.** (TEMPERATURA E LARJES).

(-- tregon larjen në ujë të ftohtë)

Temperatura shfaqet në njësinë e ekranit mbi buton.



10

SPIN (RROTULLIMET/CENTRIFUGA) (NORMA E RROTULLIMEVE/SHKARKIMI/NDALIMI I POMPËS)

Për të rregulluar normën e centrifugimit/rrotullimeve. Me normën e paracaktuar ose të përzgjedhur të centrifugimit, në njësinë e ekranit do të ndizet simboli ☉.

Në qoftë se ju zgjidhni shkarkimin, pa centrifugim, në njësinë e ekranit do të shfaqet simboli ☐☐.

Në qoftë se ju zgjidhni »Ndalimi i pompës«, në njësinë e ekranit do të shfaqet simboli ☐☐.


Zgjidhjeni funksionin »Ndalimi i pompës« ☐☐ kur doni që rrobat të rrinë të zhytura në ujë pas ciklit të fundit të shpërlarjes, në mënyrë që të mos lejohet rrudhosja e tyre kur nuk jeni në gjendje t'i merrni nga makina larëse menjëherë pas përfundimit të programit. Ju mund të vendosni normën e dëshiruar të centrifugës/rrotullimeve. Për të vazhduar programin, shtypeni butonin (3) **FILLIMI/NDALIMI**, i cili është i ndezur. Uji do të shkarkohet (do të nxirret jashtë) dhe do të fillojë cikli përfundimtar i centrifugimit.

11 + 13

BLLOKIMI PËR FËMIJËT

Një karakteristikë sigurie. Për të aktivizuar bllokimin për fëmijët, shtypni në të njëjtën kohë pozicionet (11) **START DELAY (FILLIMI ME VONESË)** dhe (13) **WATER+ (UJË+)** (NIVEL I LARTË I UJIT) dhe mbajini për të paktën tre sekonda. Përzgjedhja do të konfirmohet nga një sinjal akustik dhe dritatreguese (simboli  (12) do të ndizet). Zbatoni të njëjtën procedurë për të çaktivizuar bllokimin për fëmijët. Për atë kohë sa është i aktivizuar bllokimi për fëmijët, programi, cilësimet ose funksionet shitesë nuk mund të ndryshohen.

Bllokimi për fëmijët mbetet i aktivizuar edhe pasi makina larëse të fiket. Për arsye sigurie, bllokimi për fëmijët nuk e pengon fikjen e makinës larëse me butonin (1) NDEZJES/FIKJES/RIFILLIMIT. Për të zgjedhur një program të ri, fillimisht duhet të çaktivizohet bllokimi për fëmijët.



START DELAY (FILLIMI ME VONESË)

Përdoreni këtë funksion për të filluar ciklin e larjes pasi të ketë kaluar një periudhë e caktuar kohe. Shtypeni pozicionin (11) **START DELAY (FILLIMI ME VONESË)**. Në ekran do të shfaqet --- (11a). Në qoftë se, për shembull, ju zgjidhni një program me kohëzgjatje prej 2:39, koha do të tregohet në njësinë e ekranit dhe simboli  (11b) do të ndriçojë poshtë kohës.

Në qoftë se është zgjedhur funksioni (11) **START DELAY (FILLIMI ME VONESË)**, atëherë simboli  (11c) do të ndriçojë.


Duke shtypur pozicionin (11) **START DELAY (FILLIMI ME VONESË)**, ju mund të rregulloni kohën në hapa nga 30 minuta deri në 6 orë dhe në hapa nga 1 orë deri në 24 orë.

Në qoftë se për 5 sekonda nuk shtypet asgjë, do të shfaqet koha aktuale e larjes. Për të vendosur përsëri kohën deri në fund të programit të larjes, shtypeni pozicionin (11) **START DELAY (FILLIMI ME VONESË)**.

Funksioni aktivizohet kur shtypet butoni (3) FILLIMI/NDALIMI.

Makina larëse bën numërimin mbrapsht të kohës së vendosur. Kur numërimi mbrapsht të arrijë në zero, programi i zgjedhur i larjes do të fillojë automatikisht.


- Për të ndërprerë ose ndryshuar kohën e fillimit me vonesë, shtypeni dhe mbajeni butonin (1) NDEZJES/FIKJES/RIFILLIMIT. Shtypeni pozicionin (11) **START DELAY (FILLIMI ME VONESË)** për të zgjedhur një kohë të re vonese dhe konfirmojeni duke shtypur butonin (3) FILLIMI/NDALIMI.
- Për të anuluar menjëherë fillimin me vonesë, shtypeni dhe mbajeni pozicionin (11) **START DELAY (FILLIMI ME VONESË)** për 3 sekonda. Programi i larjes do të rifillojë.
- Në rast të ndërprerjes së energjisë elektrike përpara se të përfundojë koha e vonesës, shtypeni butonin (3) FILLIMI/NDALIMI për të rifilluar numërimin mbrapsht të kohës së vonesës.



HAPI 5: ZGJEDHJA E FUNKSIONEVE SHITESË

☼ Aktivizojini/çaktivizojini funksionet duke shtypur funksionin e dëshiruar (përpara se të shtypni butonin (3) FILLIMI/NDALIMI).

☼ Në programe të caktuara, disa cilësime nuk mund të zgjidhen. Këto funksione nuk do të ndizen në njësinë e ekranit dhe kur të shtypet butoni përkatës, do të dëgjohet një sinjal akustik dhe do të pulsojë drita në buton (shikoni TABELËN E FUNKSIONEVE).



6

GREENGUIDE

Jep informacion se sa ekonomike janë cilësimet e makinës suaj larëse.

GREENGUIDE

GREENGUIDE tregon konsumin e ujit dhe energjisë në bazë të programit të zgjedhur dhe të gjitha funksioneve ose cilësimeve shtesë. Sa më shumë simbole të jenë të ndezura, aq më shumë cilësime ekonomike keni zgjedhur dhe më pak konsum uji dhe energjie.

GREENGUIDE

GREENGUIDE tregon cilësimin e larjes më pak ekonomike me konsum më të lartë të ujit dhe energjisë.


☼ Funksioni **GREENGUIDE** ofron kontroll të vlerave të energjisë për programet e zgjedhura të larjes dhe për funksionet shtesë. Duke zgjedhur cilësime të ndryshme, përdoruesi mund të kursejë në lidhje me konsumin e ujit dhe të energjisë (p.sh. duke përdorur funksionin □ **POWERCARE**).

7

PREWASH ☺ (PARALARJA)

Larja e robave shumë të papastrta, veçanërisht me njolla të forta në sipërfaqe.

☺ Në qoftë se zgjidhni PARALARJA, detergjentin hidheni në ndarjen e paralarjes ☺.



13

WATER+ (UJË+) ⤴ (NIVEL I LARTË I UJIT)

Rrobat do të lahen me një nivel më të lartë uji (2 nivele) dhe me një shpërlarje shtesë.



Cilësimi bazë/i paracaktuar



Niveli 1 – nivel më i lartë i ujit



Niveli 2 – nivel më i lartë i ujit me një cikël shpërlarjeje shtesë

☺ Kur makina larëse fiket, të gjitha funksionet shtesë kthehen në cilësimet bazë/të personalizuar, me përjashtim të cilësimeve të sinjalit akustik.

☺ Në qoftë se keni vendosur funksionin e **START DELAY (FILLIMI ME VONESË)** dhe po përdorni detergjent të lëngshëm, ne nuk rekomandojmë vendosjen e një programi pa paralarje.

TABELA E FUNKSIONEVE

Programet		Temperatura. [°C]	NORMALCARE (KUJDES NORMAL) (basic/default setting)	POWER CARE	TIMECARE (KUJDES PËR KOHËN)	WATER+ (UJË+) (NIVEL I LARTË I UJIT)	DOSE AID	GREENGUIDE	PREWASH (PARALARJA)	NDALIMI I POMPËS	SPIN (RROTULLIMET/ CENTRIFUGA) (VENDOSJA E NORMËS SË CENTRIFUGIMIT/ RROTULLIMEVE)
	Cotton black (Pambuk i zi)	40	•		•	•	•	•		•	•
		30	•		•	•	•	•		•	•
	Cotton color (Pambuk me ngjyra)	□ 60		•				•		•	•
		□ 40		•				•		•	•
		60	•		•	•	•	•	•	•	•
		40	•		•	•	•	•	•	•	•
		30	•	•	•	•	•	•	•	•	•
		20	•	•	•	•	•	•		•	•
		--	•		•	•	•	•		•	•
	Cotton white (Pambuk i bardhë)	90	•	•	•	•	•	•	•	•	•
		60	•	•	•	•	•	•	•	•	•
		40	•	•	•	•	•	•	•	•	•
	Mix (Të përziera) (Rroba të përziera/ Sintetike)	60	•	•	•	•	•	•	•	•	•
		40	•	•	•	•	•	•	•	•	•
		30	•	•	•	•	•	•	•	•	•
		20	•	•	•	•	•	•		•	•
		--	•		•	•	•	•		•	•
	Wool/Handwash (Leshi/Larja me dorë)	40	•		•	•	•	•		•	•
		30	•		•	•	•	•		•	•
		--	•		•	•	•	•		•	•
	Speed 20' (I shpejtë 20')	30	•				•	•		•	•
	Power 59' (Fuqia 59')	40	•				•	•		•	•

- Mund të përdoren funksionet shtesë
- Program standard
- Larje me ujë të ftohtë

Programet		Temperatura. [°C]	NORMALCARE (KUJDES NORMAL) (basic/default setting)	☐ POWERCARE	TIMECARE (KUJDES PËR KOHËN)	WATER+ (UJË+) (NIVEL I LARTË I UJIT)	DOSE/ID	GREENGUIDE	PREWASH (PARALARJA)	NDALIMI I POMPËS	SPIN (RROTULLIMET/ CENTRIFUGA) (VENDOSJA E NORMËS SË CENTRIFUGIMIT/ RROTULLIMEVE)
 Steril tub (Sterilizim kazani/ Programi i vetëpastrimit)		--	•					•			
 Rinse/Softening (Shpërlarja/Zbutja) (Program i pjesshëm)		--	•			•		•		•	•
 Spin/Drain (Rrotullimet/ Centrifuga) (Norma e rrotullimeve/ Shkarkimi) (Program i pjesshëm)		--	•					•			•
 Sports (Sportive) (Veshje sportive)	40	40	•			•	•	•		•	•
	30	30	•			•	•	•		•	•
 Eco 40-60		-	•				•	•		•	•
 Allergy care (Kujdes ndaj alergjive)	90	90	•				•	•		•	•
	60	60	•				•	•		•	•
	40	40	•				•	•		•	•
 Auto wash (Larje automatike)		30	•				•	•		•	•

• Mund të përdoren funksionet shtesë

☐ Program standard


-- Larje me ujë të ftohtë

OPTIMIZIMI I KOHËS GJATË ECURISË SË PROGRAMIT

Në fazën e hershme të programit të larjes, makina larëse përdor teknologji të avancuar për të detektuar sasinë e rrobave që lahen. Pas detektimit të ngarkesës, makina larëse rregullon kohëzgjatjen e programit.

HAPI 6: FILLIMI I PROGRAMIT TË LARJES

Shtypeni butonin (3) **FILLIMI/NDALIMI**.




Në njësinë e ekranit janë treguar zgjedhjet e **MODALITETI I LARJES**, **TEMP.** (TEMPERATURA E LARJES), **SPIN (RROTULLIMET/CENTRIFUGA)** (NORMA E RROTULLIMEVE/SHKARKIMI/NDALIMI I POMPËS) dhe **KOHA E MBETUR DERI NË PËRFUNDIM TË PROGRAMIT** ☐ ose **START DELAY (FILLIMI ME VONESË)** ☐ (nëse është zgjedhur).

Simbolet do të ndriçojnë në funksionet e përzgjedhura.

Pas shtypjes së butonit (3) FILLIMI/NDALIMI, norma e rrotullimeve mund të rregullohet (duke përfshirur rastin e programit Steril tub (Sterilizim kazani/Programi i vetëpastrimit) të vetë-pastrimit dhe **SPIN (RROTULLIMET/CENTRIFUGA)** (NORMA E RROTULLIMEVE/SHKARKIMI/NDALIMI I POMPËS)) dhe mund të aktivizohet ose të çaktivizohet bllokimi për fëmijët, ndërsa cilësimet e tjera nuk mund të ndryshohen.

⚠ Në qoftë se në njësinë e ekranit nuk pulson asgjë, dera e makinës larëse është e hapur ose nuk është mbyllur siç duhet. Mbylleni derën e makinës larëse dhe shtypeni përsëri butonin (3) **FILLIMI/NDALIMI** për të vazhduar programin e larjes.

HAPI 7: NDRYSHIMI I PROGRAMIT TË LARJES OSE ANULIMI MANUAL (FIZIK)



1 Për të ndaluar dhe anuluar një program larjeje, shtypeni butonin (1) NDEZJES/FIKJES/ RIFILLIMIT dhe mbajeni të shtypur për më shumë se 3 sekonda.


2 Programi i larjes është **përkohësisht i ndaluar** kur pulson koha e mbetur deri në përfundimin e programit . Në të njëjtën kohë, makina larëse do ta nxjerrë ujin jashtë nga kazani i makinës larëse. Kur uji të jetë nxjerrë jashtë, dera e makinës do të zhblllokohet. Në qoftë se uji në makinën larëse është i nxehtë, makina larëse do ta ftohë dhe do tanxjerrë/shkarkojë atë automatikisht.

HAPI 8: PËRFUNDIMI I PROGRAMI TË LARJES

Makina larëse do të tregojë përfundimin e programit të larjes me një sinjal akustik dhe në ekran do të shfaqet »End« derisa makina të kalojë në modalitetin e gatishmërisë së ulët ose të fiket. Pas 5 minutash, shenja »End« nuk do të shfaqet më.



1. Hapeni derën e makinës larëse.
2. Merrini rrobat nga kazani.
3. Fshijeni guarnicionin prej gome të derës dhe xhamin e derës.
4. Mbylleni derën!
5. Mbylleni rubinetin e furnizimit me ujë.
6. Fikeni makinën larëse (shtypeni butonin (1) NDEZJES/**FIKJES**/RIFILLIMIT).
7. Hiqeni kabllin e energjisë nga priza.



NDËRPRERJET DHE NDRYSHIMI I PROGRAMIT

NDËRPRERJA MANUALE

Për të ndaluar dhe anuluar një program larjeje, shtypeni butonin (1) **NDEZJES/FIKJES/RIFILLIMIT** dhe mbajeni të shtypur për më shumë se 3 sekonda. Nëekran do të pulsojnë dritat e sinjalit. Në të njëjtën kohë, makina larëse do ta nxjerrë ujin jashtë nga kazani i makinës larëse. Kur uji të jetë nxjerrë jashtë, dera e makinës do të zhbllokohet. Në qoftë se uji në makinën larëse është i nxehtë, makina larëse do ta ftohë dhe do tanxjerrë/shkarkojë atë automatikisht.

CILËSIMET PERSONALE

Mund të ndryshohen edhe cilësimet bazë ose të paracaktuara për secilin program larjeje. Kur zgjidhni programin dhe funksionet shtesë, ju mund ta ruani këtë kombinim duke shtypur butonin (3) **FILLIMI/NDALIMI** dhe duke e mbajtur për pesë sekonda. Kur të ruhet programi i larjes, të gjitha dritat do të pulsojnë. Në ekran do të shfaqet **S C**.

Programi do të mbetet i ruajtur derisa të ndryshohet duke përdorur të njëjtën procedurë.

Cilësimet personale mund të rivendosen edhe për cilësimet e fabrikës në menunë e përdoruesit.

MENUJA ECILËSIMEVE PERSONALE

Ndizeni makinën larëse duke shtypur butonin (1) **NDEZJES/FIKJES/RIFILLIMIT**. Për të hapur Menunë e cilësimeve personale shtypini në të njëjtën kohë pozicionet (10) **SPIN (RROTULLIMET/ CENTRIFUGA)** (NORMA E RROTULLIMEVE/SHKARKIMI/NDALIMI I POMPËS) dhe (13) **WATER+ (UJË+)** (NIVELI I LARTË I UJIT). Në njësinë e ekranit do të ndizen dritat e sinjaleve të **POWERCARE**, **TIMECARE** (KUJDES PËR KOHËN), **DOSEAID** dhe **GREENGUIDE**. Në ekranin LED do të shfaqet numri 1, i cili tregon edhe funksionin e cilësimeve. Rrotullojeni çelësin e përzgjedhjes së programit (2) nga e majta ose nga e djathta për të zgjedhur funksionin që do të ndryshohet.

Shtypni në pozicionin **TEMP.** (TEMPERATURA E LARJES) për të konfirmuar funksionet e dëshiruara dhe cilësimet përkatëse. Shtypeni pozicionin (7) **PREWASH (PARALARJA)** për t'u kthyer mbrapa një hap. Në qoftë se cilësimet e dëshiruara nuk përzgjidhen për 20 sekonda, programi do të kthehet automatikisht në menunë kryesore.

Numri 1 tregon cilësimet e **Volumit të sinjalit akustik**. Volumi i sinjalit akustik mund të vendoset në katër nivele (0 do të thotë që volumi është i fikur; 1 do të thotë që volumi i butonave është i aktivizuar; 2 do të thotë volum i ulët dhe 3 do të thotë volum i lartë). Zgjidhni nivelin e volumnit duke rrotulluar çelësin e përzgjedhjes së programit (2) nga e majta ose nga e djathta. Cilësimi më i ulët do të thotë që sinjali akustik është i fikur.

Numri 2 tregon cilësimin e **Fortësisë së ujit**. Fortësia e ujit mund të vendoset në tre nivele. Për të zgjedhur nivelin e fortësisë së ujit, rrotullojeni çelësin e përzgjedhjes së programit (2) nga e majta ose nga e djathta dhe zgjidhni ndërmjet ujit të butë (2:1), të mesëm (2:2) dhe të fortë (2:3).

☼ Që funksioni (5) **DOSEAID** të funksionojë siç duhet, rekomandojmë vendosjen e nivelit të saktë të ashpërsisë së ujit.

Numri 3 tregon rivendosjen e **Cilësimeve të programit personal** sipas paracaktimit të fabrikës.

BUTONII NDALIMIT

Programi i larjes mund të ndalohet gjithmonë duke shtypur butonin (3) **FILLIMI/NDALIMI** Programi i larjes është **përkohësisht i ndaluar** kur pulson koha e mbetur deri në përfundimin e programit ☒ . Në qoftë se në kazan nuk ka ujë dhe temperatura e ujit nuk është shumë e lartë, atëherë dera do të zhblokohet pas një periudhe të caktuar kohore dhe mund të hapet. Për të rifilluar programin e larjes, fillimisht mbylleni derën dhe pastaj shtypni butonin (3) **FILLIMI/NDALIMI**.

SHTIMI/HEQJA E RROBAVE GJATË OPERIMIT TË MAKINËS LARËSE – STOP ADD GO+

Pas një periudhe të caktuar kohore, dera e makinës larëse mund të hapet në qoftë se niveli i ujit dhe temperaturës janë më poshtë se pragu i paracaktuar.

Në qoftë se plotësohen kushtet e mëposhtme, atëherë bllokuesi elektronik i derës lirohet dhe dera e makinës larëse mund të hapet:

- temperatura e ujit në kazan duhet të jetë e përshtatshme,
- niveli i ujit në kazan duhet të jetë poshtë një niveli të caktuar.

Në mënyrë që të shtoni ose të hiqni rroba nga makina larëse gjatë funksionimit të programit, veproni si më poshtë:

1. Shtypni butonin (3) **FILLIMI/NDALIMI**.
2. Në qoftë se plotësohen të gjitha kushtet për lirin e bllokuesit elektronik të derës, atëherë mund ta hapni derën e makinës larëse dhe të shtoni ose të hiqni rroba nga kazani:
 - Në rast se niveli i ujit në kazan është mbi një nivel të caktuar, kjo do të tregohet nga pulsimi i simbolit **WATER+ (UJË+)** ☼ (NIVEL I LARTË I UJIT). Në rast se e shtypni pozicionin **WATER+ (UJË+)** (NIVEL I LARTË I UJIT), uji do të pompohet jashtë kazanit deri në nivelin i cili lejon zhblokimin e mbylljes së derës. Atëherë, ju mund të hapni derën e makinës larëse dhe të shtoni ose të hiqni rroba nga makina larëse.
 - Në rast se temperatura e ujit në kazan është mbi një nivel të caktuar, kjo do të tregohet nga pulsimi i funksionit ☐ **POWERCARE**. Në këtë rast, prisni derisa uji në kazan të ftohet. Kur uji të ftohet deri në një temperaturë të përshtatshme, funksioni ☐ **POWERCARE** do të ndalojë pulsimin dhe do të zhblokohet mbyllja e derës. Atëherë, ju mund të hapni derën e makinës larëse dhe të shtoni ose të hiqni rroba nga makina larëse.
3. Mbylleni derën e makinës larëse!
4. Shtypni butonin (3) **FILLIMI/NDALIMI**.

Programi i larjes do të rifillojë.

☼ Në qoftë se ju gjatë larjes shtoni një sasi të konsiderueshme rrobash, rrobat mund të lahen me më pak efektivitet, sepse makina larëse fillimisht ka pasur një peshë më të vogël të ngarkesës së rrobave dhe ka marrë një sasi më të vogël uji. Sasia e pamjaftueshme e ujit, krahasuar me sasinë e rrobave mund të shkaktojë edhe dëmtime të rrobave (rrudhosje të rrobave të thata), dhe koha e larjes mund të jetë më e gjatë.

☼ Koha e larjes do të rifillojë nga pika në të cilën ishte ndërprerë programi i larjes.

GABIMET

Në rast të një gabimi ose defekti, programi do të ndërpritet.

Dritat sinjalizuese që pulsojnë dhe një sinjal akustik do të njoftojnë për një ngjarje të tillë (shikoni TABELËN E ZGJIDHJES SË PROBLEMEVE) dhe gabimi do të tregohet në ekran (E:XX).


DEFEKT NË FURNIZIMIN ME ENERGJI

Në rast të një defekti në furnizimin me energji, programi i larjes do të ndërpritet. Kur rikthehet furnizimi me energji, në njësinë e ekranit do të shfaqet »PF« (Ndërprerja e Energjisë). Për të rifilluar programin e larjes, shtypeni butonin (3) **FILLIMI/NDALIMI**.

Koha e vonësës nuk do të rivendoset.

Koha e larjes do të rifillojë nga pika në të cilën ishte ndërprerë programi i larjes.

HAPJA E DERËS MANUALISHT NË RAST TË NDËRPRERJES SË ENERGJISË - NË RAST TË NDALIMIT TËNJË PROGRAMI



1 Kur programi ndalohet ose ndërpritet, hapeni kapakun e filtrit duke përdorur një mjet të përshtatshëm (kaçavidë të sheshtë ose një mjet të ngjashëm).

2 Dera e makinës larëse mund të hapet vetëm duke tërhequr në të njëjtën kohë levën speciale (të vendosur në filtër) dhe dorezën e derës.

3 Hapeni manualisht derën e makinës larëse, duke e tërhequr dorezën drejt vetes.

HAPJA E DERËS (NDALIMI/ANULIMI – NDRYSHIMI I PROGRAMIT)

Dera e makinës larëse mund të hapet në qoftë se niveli i ujit në makinën larëse është mjaftueshëm i ulët dhe në qoftë se temperatura e ujit nuk është shumë e lartë. Në të kundërt, përdoreni ndërprerjen manuale (fizike) (shikojeni kapitullin »NDËRPRERJET DHE NDRYSHIMI I PROGRAMIT/Ndërprerja manuale (fizike)«).

⚠ Në qoftë se pas ndërprerjes së energjisë ka ende ujë në makinën larëse, sigurohuni që të mos e hapni derën përpara se tashkarkoni manualisht ujin nga makina larëse duke përdorur filtrin e pompës (shikoni kapitullin »PASTRIMI DHE MIRËMBAJTJA/Pastrimi i filtrit të pompës«).


MIRËMBAJTJA DHE PASTRIMI

⚠ Përpara pastrimit, hiqeni makinën larëse nga rrjeti elektrik.

☀ Fëmijët nuk duhet ta pastrojnë makinën larëse ose të kryejnë detyra të mirëmbajtjes pa mbikëqyrjen e duhur!


PASTRIMI I KUTISË SHPËRNDARËSE

☀ Kutia shpërndarëse duhet të pastrohet të paktën dy herë në muaj.



☀ Mos e lani kutinë shpërndarëse në pjatlarëse (lavastovilje).

PASTRIMI ITUBIT TË FURNIZIMIT ME UJË, ZGAVRËS TË SHPËRNDARJES SË DETERGJENTIT DHE GUARNICIONIT PREJ GOME TË DERËS




1 Rrjetën e filtrit pastrojeni shpesh, me ujë të rrjedhshëm.

2 Për të pastruar të gjithë pjesën e shpëlarjes së makinës larëse, veçanërisht vrimat në pjesën e sipërme të dhomës së shpëlarjes, përdorni një furçë.

3 Pas çdo larjeje, fshijeni guarnicionin prej gome të derës për të rritur jetëgjatësinë e tij.

PASTRIMI I FILTRIT TË POMPËS

☼ Gjatë pastrimit, mund të derdhet pak ujë. Për këtë arsye rekomandohet që të vendosni një leckë thithëse në dyshe.



1 Hapeni kapakun e filtrit të pompës duke përdorur një mjet të përshtatshëm (kaçavidë të sheshtë ose një mjet të ngjashëm).

2 Përpara se të pastroni filtrin e pompës, nxirreni gypin e shkarkimit të ujit. Rrotullojeni filtrin e pompës ngadalë në drejtim të kundërt me lëvizjen e akrepave të orës. Nxirreni dhe hiqeni filtrin e pompës për të lejuar ujin që të rrjedhë ngadalë.

3 Pastrojeni plotësisht filtrin e pompës, me ujë të rrjedhshëm.

4,5 Hiqini të gjitha objektet dhe papastërtitë nga zgavra e filtrit dhe nga helika e pompës. Vendoseni përsëri filtrin e pompës siç tregohet në figurë dhe shtërrojeni duke e rrotulluar në drejtim të lëvizjes së akrepave të orës. Për një puthitje të mirë, sipërfaqja e guarnicionit të filtrit duhet të jetë e pastër.

⚠ Pastrojeni filtrin e pompës dhe sifonin e ujit në mur, sa herë që në njësinë e ekranit të shfaqet simboli (8).

☼ Filtri i pompës duhet të pastrohet herë pas here, sidomos pas larjes së rrobave me shumë vatinë, prej leshi ose shumë të vjetra.


PASTRIMI I PJESËS SË JASHTME TË MAKINËS LARËSE

⚠ Përpara pastrimit, makinën larëse shkëputeni gjithmonë nga rrjeti elektrik.

Pastrojeni pjesën e jashtme të makinës larëse dhe njësinë e ekranit duke përdorur një lectë të butë prej pambuku, të lagur me ujë.

⚠ Mos përdorni asnjë lloj agjenti tretës ose pastrues që mund të dëmtojë makinën larëse (ju lutemi të zbatoni rekomandimet dhe paralajmërimet e dhëna nga prodhuesit e agjentëve të pastrimit).

💧 Mos e pastroni makinën larëse me ujë me presion!



ZGJIDHJA E PROBLEMEVE

ÇFARË TË BËJMË ...?

Makina larëse do të kontrollojë automatikisht operimin e funksioneve të veçanta gjatë ciklit të larjes. Në qoftë se identifikohet ndonjë parregullsi, kjo do të tregohet duke raportuar (E:XX) në ekran. Makina larëse do ta raportojë gabimin derisa të fiket. Çrregullimet nga mjedisi (p.sh. nga rrjeti elektrik) mund të rezultojnë në raportime të ndryshme të gabimeve (shikoni TABELËN PËR ZGJIDHJEN E PROBLEMEVE). Në këtë rast:

- Fikeni makinën larëse dhe prisni disa sekonda.
- Ndizeni makinën larëse dhe përsëriteni programin e larjes.
- Shumica e gabimeve gjatë operimit mund të zgjidhen nga përdoruesi (shikoni TABELËN PËR ZGJIDHJEN E PROBLEMEVE).
- Në qoftë se gabimi vazhdon, telefononi një njësi shërbimi të autorizuar.
- Riparimet mund të kryhen vetëm nga një person i trajnuar në mënyrë të përshtatshme.
- Riparimi ose çfarëdo pretendim për garanci që rezulton nga lidhja ose përdorimi i parregullt i makinës larëse nuk do të mbulohet nga garancia. Në raste të tilla, shpenzimet e riparimit do t'i ngarkohen përdoruesit.

⚠️ Garancia nuk i mbulon gabimet ose defektet të cilat rezultojnë nga çrregullimet e mjedisit (goditjet nga rrufetë, defektet e rrjetit elektrik, fatkeqësitë natyrore, etj.).

TABELA E ZGJIDHJES SË PROBLEMEVE DHE GABIMEVE

Problemi/ gabimi	Treguesi në njësinë e ekranit dhe përshkrimi i problemit	Çfarë të bëjmë?
E0	Cilësime të parregullta 	Rifillojeni programin. Në qoftë se gabimi ndodh përsëri, thërrisni një teknik shërbimi.
E1	Gabim i sensorit të temperaturës 	Uji në hyrje është shumë i ftohtë. Përsëriteni programin e larjes. Në qoftë se makina larëse e raporton përsëri këtë gabim, thërrisni një teknik shërbimi.
E2	Gabim i mbylljes së derës 	Sigurohuni që dera e makinës larëse është e mbyllur. Hiqeni kabllin elektrik nga priza; pastaj, vendoseni përsëri në prizë kabllin elektrik dhe ndizeni makinën larëse Në qoftë se gabimi ndodh përsëri, thërrisni një teknik shërbimi.
E3	Gabim i mbushjes me ujë 	Kontrolloni sa më poshtë: • është i hapur rubineti i hyrjes së ujit, • është i pastër filtri në tubin e furnizimit me ujë, • është i shtrembëruar tubi i furnizimit me ujë (i shtypur, i bllokuar, etj.), • nëse presioni në tubacionin e ujit është midis 0.05 dhe 0.8 MPa (0.5 - 8 bar). Pastaj, shtypeni butonin (3) FILLIMI /NDALIMI për të rifilluar programin. Në qoftë se gabimi ndodh përsëri, thërrisni një teknik shërbimi.
E6	Gabim i nxehjes së ujit 	Rifillojeni programin. Në qoftë se gabimi ndodh përsëri, thërrisni një teknik shërbimi.
E7	Gabim i shkarkimit të ujit 	Kontrolloni sa më poshtë: • është i pastër filtri i pompës, • është i shtypur tubi i shkarkimit, • është i bllokuar shkarkimi, • nëse tubi i shkarkimit është vendosur poshtë lartësisë maksimale dhe sipër lartësisë minimale (shikoni kapitullin »INSTALIMI DHE LIDHJA/Lidhja dhe sigurimi i tubit të shkarkimit të ujit«); Pastaj, shtypeni përsëri butonin (3) FILLIMI /NDALIMI. Në qoftë se gabimi ndodh përsëri, thërrisni një teknik shërbimi.

Problemi/ gabimi	Treguesi në njësinë e ekranit dhe përshkrimi i problemit	Çfarë të bëjmë?
E9	Në fundin e makinës larëse detektohet ujë (Sistemi Total Aqua Stop) 	Fikeni pajisjen elektroshtëpiake dhe ndizeni përsëri. Në qoftë se gabimi përsëritet, thërrisni një teknik shërbimi.
E10	Gabim i sensorit të nivelit të ujit 	Hiqeni kabllin elektrik nga priza; pastaj, vendoseni përsëri në prizë kabllin elektrik dhe ndizeni makinën larëse Në qoftë se gabimi ndodh përsëri, thërrisni një technik shërbimi.
E11	Tejmbushje me ujë 	Në qoftë se në kazan ka ujë që e kalon nivelin e caktuar dhe në njësinë e ekranit raportohet një gabim, do të ndërpritet programi i larjes dhe uji do të nxirret nga makina larëse. Rifillojeni programin. Në qoftë se gabimi përsëritet, thërrisni një teknik shërbimi. Në qoftë se në kazan ka ujë që e kalon nivelin e caktuar dhe në njësinë e ekranit raportohet një gabim, ndërkohë që makina larëse vazhdon të marrë ujë, mbylleni rubinetin e ujit dhe thërrisni një technik shërbimi.
E12	Gabimet/defektet e kontrollit të motorit 	Rifillojeni programin. Në qoftë se gabimi ndodh përsëri, thërrisni një teknik shërbimi.
E22	Gabim gjatë mbylljes së derës 	Dera është e mbyllur, por nuk mund të bllokohet. Fikeni makinën larëse. Ndizeni përsëri dhe rifillojeni programin e larjes. Në qoftë se gabimi përsëritet, thërrisni një teknik shërbimi.
E23	Gabim gjatë mbylljes së derës. 	Dera është e mbyllur, por nuk mund të zhblokohet. Fikeni makinën larëse, pastaj ndizeni përsëri. Në qoftë se gabimi ndodh përsëri, thërrisni një teknik shërbimi. Për të hapur derën, shikoni kapitullin »NDËRPRERJET DHE NDRYSHIMI I PROGRAMIT/ Hapja manuale e derës«.
E36	Problem i komunikimit elektronik në makinën larëse 	Hiqeni kabllin elektrik nga priza; pastaj, vendoseni përsëri në prizë kabllin elektrik dhe ndizeni makinën larëse Në qoftë se gabimi ndodh përsëri, thërrisni një technik shërbimi.
E37	Problem i komunikimit elektronik në makinën larëse 	Hiqeni kabllin elektrik nga priza; pastaj, vendoseni përsëri në prizë kabllin elektrik dhe ndizeni makinën larëse Në qoftë se gabimi ndodh përsëri, thërrisni një technik shërbimi.

Problem/ gabimi	Treguesi në njësinë e ekranit dhe përshkrimi i problemit	Çfarë të bëjmë?
	Sinjalizim për sistemin e shkarkimit të ujit Do të shfaqet simboli 	Sinjalizim për zvogëlimin e rrjedhjes së ujit në fazën e nxjerrjes. Kontrolloni sa më poshtë: • është i pastër filtri i pompës, • është i shtypur tubi i shkarkimit, • është i bllokuar shkarkimi, • nëse tubi i shkarkimit është vendosur poshtë lartësisë maksimale dhe sipër lartësisë minimale (shikoni kapitullin »INSTALIMI DHE LIDHJA/Lidhja dhe siguri i tubit të shkarkimit të ujit«).
	Robra të shpërndara jo njëtrajtësisht. Kur të përfundojë programi i larjes, simboli i centrifugës  në njësinë e ekranit do të mbetet i ndezur.	Shpërndajini rrobat me dorë dhe filloni programin e centrifugimit. Shikoni përshkrimin shtesë poshtë TABELËS PËR ZGJIDHJEN E PROBLEMEVE/DEFEKTEVE.
cln	Paralajmërim i sistemit për të filluar programin Steril tub (Sterilizim kazani/ Programi i vetëpastrimit)  Pasi programi i larjes të ketë përfunduar, në njësinë e ekranit do të alternohen shenjat »cIn« dhe »End«.	Ne rekomandojmë fillimin e programit Steril tub (Sterilizim kazani/Programi i vetëpastrimit).
»PF«	Sinjalizimet për defektet e energjisë elektrike (»PF«/ Ndërprerja e Energjisë) 	Programi i larjes është ndërprerë për shkak të defektit të energjisë elektrike. Për të rifilluar, shtypeni butonin (3) FILLIMI/NDALIMI .
	Nuk reagon njësia e ekranit dhe asnjë nga butonat	Ndalojeni manualisht (fizikisht) programin duke shtypur butonin (1) NDEZJES/FIKJES/RIFILLIMIT dhe mbajeni të shtypur për më shumë se 3 sekonda. Hiqeni kabllin elektrik nga priza; pastaj, vendoseni përsëri në prizë kabllin elektrik dhe ndizeni makinën larëse Në qoftë se gabimi ndodh përsëri, thërrisni një teknik shërbimi.
	Pozicioni në gatishmëri i makinës larëse, gati për të rivazhduar programin e larjes Koha e mbetur deri në përfundim të programit ndizet dhe fiket në mënyrë të alternuar në njësinë e ekranit  .	Për të rivazhduar programin e larjes, shtypeni butonin (3) FILLIMI/NDALIMI ose ndalojeni programin manualisht (fizikisht), shtypeni butonin (1) NDEZJES/FIKJES/RIFILLIMIT dhe mbajeni të shtypur për më shumë se 3 sekonda.

Problem/gabimi	Treguesi në njësinë e ekranit dhe përshkrimi i problemit	Çfarë të bëjmë?
	Përgatitja për të zhblokuar derën Dritat e sinjaleve do të pulsojnë në njësinë e ekranit. 	Prisni derisa të përfundojë procesi. Në qoftë se pas procesit nuk tregohet asnjë gabim, atëherë mund të fillojë një program i ri. Uji duhet të shkarkohet. Prisni derisa dera të zhblokohet.
	Zhurmë dhe dridhje	Duke përdorur këmbët e rregullueshme, sigurohuni që pajisja është e niveluar dhe që dadot janë shtrënguar mirë.

Rrobat e shpërndara jo njëtrajtësisht ose të mbledhura përgjithësisht në makinën larëse mund të shkaktojnë probleme si dridhjet dhe operimi me zhurmë. Makina larëse do t'i konstatojë këto probleme dhe do të aktivizohet sistemi UKS* (*sistemi i kontrollit të qëndrueshmërisë). Ngarkesat më të vogla (p.sh. një peshqir, një pulover, njëpeshqir dushi, etj.) ose rrobat e prodhuara nga materiale me karakteristika të veçanta gjeometrike, praktikisht është e pamundur të shpërndahen njëtrajtësisht në të gjithë kazanin e makinës larëse (pantoflat, sendet e mëdha, etj.). Kjo rezulton në disa përpjekje për të rishpërndarë rrobat, të cilat si rezultat çojnë në kohëzgjatje më të madhe të programit. Në raste ekstreme kushtesh të pafavorshme, programi mund të përfundojë pa ciklin e centrifugimit.

Sistemi UKS* (*sistemi i kontrollit të qëndrueshmërisë) lejon operim të qëndrueshëm dhe jetëgjatësi më të madhe të makinës larëse.

Në qoftë se problemi vazhdon pavarësisht zbatimit të këshillës së mësipërme, thërrisni një teknik të autorizuar shërbimi. Riparimi ose çfarëdo pretendim për garanci që rezulton nga lidhja ose përdorimi i parregullt i makinës larëse nuk do të mbulohet nga garancia. Në raste të tilla, shpenzimet e riparimit do të mbulohen nga përdoruesi.

RIPARIMI/SHËRBIMI


Përpara se të thërrisni një teknik shërbimi

Kur të kontaktoni një qendër shërbimi, ju lutemi të tregoni llojin e makinës suaj larëse (1), kodin/ID-në (2), numrin e modelit (3) dhe numrin serial (4).


Lloji, kodi/ID-ja, modeli dhe numri serial janë dhënë në pllakën e të dhënave (llojit) që ndodhet në anën e përparme të hapjes së derës të makinës larëse.

⚠ Në rast defekti, përdorni vetëm pjesë këmbimi të miratuara, nga prodhuesi i autorizuar.

⚠ Riparimi ose çfarëdo pretendim për garanci që rezultojnë nga lidhja ose përdorimi i parregullt i makinës larëse nuk do të mbulohet nga garancia. Në raste të tilla, shpenzimet e riparimit do të ngarkohen përdoruesit.



1 2 3 4



Pajisjet dhe aksesoret shtesë për mirëmbajtjen mund të shihen në faqen tonë të internetit në: www.gorenje.com

REKOMANDIME PËR LARJEN DHE PËRDORIMIN EKONOMIK TË MAKINËS SUAJ LARËSE

Herën e parë, rrobat e reja me ngjyrë lajini veç e veç.

Rrobat shumë të ndotura lajini në sasi më të vogla, me më shumë detergjent pluhur ose me një cikël paralarjeje.

Përpara larjes, mbi njollat e forta përdorni heqës të posaçëm njollash. Ne rekomandojmë të referoheni në KËSHILLAT PËR HEQJEN E NJOLLAVE.

Me rrobat pak të ndotura, ne rekomandojmë një program pa ciklin e paralarjes, përdorimin e programeve më të shkurtra (p.sh. **TIMECARE** (KUJDESI PËR **KOHËN**)) dhe një temperaturë më të ulët larjeje.

Në qoftë se ju lani shpesh në temperatura të ulëta dhe me detergjentë të lëngshëm, në makinën larëse mund të shumohen baktere të cilat mund të shkaktojnë aroma të këqia. Për të mos lejuar këto aroma, ne rekomandojmë që të përdorni herë pas here programin Steril tub  (Sterilizim kazan/Programi i vetëpastrimit) (shikoni TABELËN E PROGRAMEVE).

Ne rekomandojmë shmangien e larjes së sasive shumë të vogla të rrobave, pasi kjo do të çojë në përdorim të tepër të energjisë elektrike dhe në një performancë më të dobët të makinës larëse.

Shpalosini të gjitha rrobat e palosura përpara se t'i fusni në kazan. Përdorni vetëm detergjentë për larje me makinë.

Në rast se në makinën larëse krijohet shkurthë e tepërt apo rrjedh shkurthë nga tabakaja e shpërndarjes së detergjentit, makina larëse duhet të shpëlahet plotësisht me një sasi të madhe uji. Zgjidhni një program larjeje, por mos hidhni asnjë detergjent.

Detegjentët në formë pluhuri apo lëngu, shtojini sipas udhëzimeve të prodhuesit, duke marrë parasysh temperaturën e larjes, programin e larjes, sa të ndotura janë rrobat dhe fortësinë e ujit.

Në qoftë se fortësia e ujit e tejkalon 14°dH, duhet të përdoret zbutës uji. Dëmet e nxehtësisë që rezultojnë nga përdorimi i parregullt i zbutësve të ujit nuk duhet të mbulohet nga garancia. Kontrolloni informacionin për fortësinë e ujit me shoqërinë ose autoritetin lokal të furnizimit me ujë.

Përdorimi i zbardhuesve me bazë klori nuk është i rekomanduar, pasi ato mund të dëmtojnë nxehtësinë.

Mos hidhni kokrra të forta të detergjentit pluhur në shpërndarësin e detergjentit, pasi ato mund të bllokojnë gypat e makinës larëse.


Kur përdorni produkte të lëngshme dhe të trasha për kujdesin e rrobave, ne rekomandojmë hollimin e tyre me ujë, për të mos lejuar bllokimin e shkarkimit të kutisë shpërndarëse.

Detergjentët e lëngshëm janë synuar për programet e larjes pa ciklin e paralarjes.

Në normat e larta të rrotullimeve/centrifugimit, në rroba do të ketë më pak lagështirë të mbetur. Si rezultat, tharja në tharës me ajër të nxehtë do të jetë më e shpejtë dhe më ekonomike.

Fortësia e ujit	Nivelet e fortësisë			
	°dH (°N)	m mol/l	°fH(°F)	p.p.m.
1 - i butë	< 8,4	< 1,5	< 15	< 150
2 - normal	8,4 - 14	1,5 - 2,5	15 - 25	150 - 250
3 - i fortë	> 14	> 2,5	> 25	> 250

☼ Kontrollojeni informacionin për fortësinë e ujit me shoqërinë ose autoritetin lokal të furnizimit me ujë.



1 Me makinën larëse është dhënë një kapëse ndarëse/veçuese, e cila lejon hedhjen e detergjentit të lëngshëm në ndarjen kryesore të larjes ☺ (ndarja majtas).

2 Treguesi i detergjentit pluhur dhe të lëngshëm.

3 Kur përdoret detergjent pluhur, kapësja ndarëse/veçuese duhet të ngrihet.

4 Kur përdoret detergjent i lëngshëm, kapësja ndarëse/veçuese duhet të ulet.

Simbolet e ndarjeve të shpërndarësit të detergjentit

☺	paralarja
☺	larja kryesore
☼	zbutja

☼ Ne rekomandojmë hedhjen e detergjentit pluhur menjëherë përpara ciklit të larjes. Në qoftë se ju e hidhni më shpejt, sigurohuni që përpara se të hidhni detergjentin pluhur, ndarja e detergjentit në kutinë shpërndarëse të jetë krejtësisht e thatë: në të kundërt, detergjenti pluhur mund të zerë kore përpara fillimit të procesit të larjes.

☼ Hidheni kondicionerin në kutinë shpërndarëse, në ndarjen me simbolin ☼. Zbatoni rekomandimin në paketimin e kondicionerit.

☼ Mos e mbushni ndarjen e kondicionerit mbi treguesin e maksimumit (niveli maksimal i treguar). Në të kundërt, kondicioneri do të hidhet shumë shpejt në roba, duke çuar në një efekt më të dobët të larjes.

KËSHILLA PËR HEQJEN E NJOLLAVE

Përpara përdorimit të heqësve specialë të njollave, për njollat jo shumë të forta provoni të përdorni mënyrat natyrale të cilat nuk e dëmtojnë mjedisin.

Megjithatë, kërkohet veprimi i menjëhershëm! Njomeni njollën me një sfungjer thithës ose me një pecetë letre; pastaj shpërlajeni me ujë të ftohtë (të vakët) – por asnjëherë me ujë të nxehtë!

Njollat	Heqja e njollave
Baltë	Kur njolla është e thatë, fillimisht kruajeni nga rrobatpërpara se ta lani në makinën larëse. Në qoftë se njolla është e fortë, përpara larjes njomeni me një heqës njollash me bazë enzime. Në qoftë se njolla nuk është e fortë, përpara larjes, lajeni rrobën me detergjent të lëngshëm ose me detergjent pluhur dhe me ujë.
Deodorant kundër djersës	Përpara larjes në makinë larëse, mbi rrobën përdorni detergjent të lëngshëm. Përdorni heqës njollash mbi të gjitha njollat e forta. Në mënyrë alternative, për larjen përdorni zbardhues me bazë oksigjeni.
Çaj	Futeni ose shpërlajeni rrobën me ujë të ftohtë dhe nëse është e nevojshme, hidhni heqës njollash.
Çokollatë	Futeni ose shpërlajeni rrobën me ujë të vakët dhe me sapun. Pastaj, përdorni lëng limoni dhe shpërlajeni.
Bojë shkrimi	Përpara larjes në makinë larëse, mbi njollat përdorni heqës njollash. Mund të përdorni edhe alkool të denaturuar. Kthejeni pjesën e brendshme të veshjes mbrapsht dheposhtë njollës vendosni një pecetë letre. Në përfundim të procesit, shpërlajeni veshjen plotësisht.
Markera (bojra me depozitë)	Tretni pak niseshte në ujë dhe vendoseni mbi njollën. Kur të thahet, hiqeni duke e kruajtur me një furçë; pastaj, lajeni veshjen në makinën larëse.
Ushqime fëmijësh (urinë, baltë, njolla ushqimesh)	Përpara larjes në makinë larëse, futini njollat në ujë të vakët për të paktën gjysëm ore. Për heqje më të lehtë të njollave, hidhni një heqës njollash me bazë enzime.
Bar	Përpara larjes në makinë larëse, futeni rrobën në një heqës njollash me bazë enzime. Njollat e barit mund të hiqen edhe duke i zhytur (afërsisht për 1 orë) në lëng limoni të holluar ose në uthull të distiluar (vere).
Vezë	Futeni veshjen në një heqës njollash me bazë enzime. Futeni në ujë të ftohtë për të paktën 30 minuta ose për disa orë në qoftë se njollat janë të forta. Pastaj, lajini në makinë larëse.
Kafe	Futeni veshjen në ujë të kripur. Në qoftë se njolla nuk është e freskët, futeni në një përzierje me glicerinë, amoniak dhe alkool.
Bojë këpucësh	Hidhni vaj gatimi mbi njollën dhe shpërlajeni.
Gjak	Njollat e freskëta – shpërlajeni veshjen me ujë të ftohtë dhe lajeni në makinë larëse. Njollat e thara – futeni veshjen në një heqës njollash me bazë enzime. Pastaj, lajeni në makinë larëse. Në qoftë se njolla nuk është zhdukur, provoni ta hiqni me një zbardhues të përshtatshëm për veshjen tuaj.

Njollat	Heqja e njollave
Ngjitës, çimçakiz	Futeni veshjen në një qese dhe vendoseni në ngrirje derisa njolla të forcohet. Pastaj, hiqeni me një thikë jo të mprehtë. Më pas, hollojeni njollën me një heqës njollash para larjes dhe shpërlajeni plotësisht. Pastaj, lajeni veshjen si zakonisht.
Makeup	Përdorni një heqës njollash për paralarjen; pastaj, lajeni në makinë larëse.
Gjalpë	Përpara larjes në makinë larëse, mbi njollën vendosni heqës njollash. Pastaj, shpërlajeni me ujë të nxehtë (aq të nxehtë sa mund ta lejojë materiali tekstil).
Qumësht	Futeni veshjen në një heqës njollash me bazë enzime. Futeni të paktën për 30 minuta ose për disa orë në qoftë se njollat janë të forta. Pastaj, lajeni në makinë larëse.
Lëng frutash	Përdorni një përzierje prej kripe dhe uji mbi njollën. Lereni pak kohë të veprojnë, pastaj shpërlajeni. Përpara larjes në makinë larëse, mbi njollë mund të përdorni edhe bikarbonat natriumi, uthull të distiluar ose lëng limoni. Për njollat e vjetra, përdorni glicerinë. Pas 20 minutash, shpërlajeni me ujë të ftohtë, pastaj lajeni rrobën në makinë larëse.
Verë	Futni rrobën në ujë të ftohtë për të paktën 30 minuta. Përdorni edhe heqës njollash. Pastaj, lajeni në makinë larëse.
Dyllë	Vendoseni veshjen në ngrirje derisa dylli të forcohet. Pastaj, kruajeni për ta hequr. Hiqeni dyllin e mbetur duke vendosur një pecetë letre mbi njollë dhe pastaj nxeheni duke e hekurosuar derisa letra ta thithë dyllin.
Djersë	Përpara larjes në makinë larëse, fërkojeni njollën plotësisht me detergjent të lëngshëm.
Çimçakiz	Vendoseni veshjen në ngrirje derisa çimçakizi të forcohet. Pastaj, kruajeni për ta hequr. Më pas, lajeni në makinë larëse.

HEDHJA

Paketimi përbëhet prej materialesh miqësore ndaj mjedisit dhe mund të riciklohet, të hidhet ose të shkatërrohet pa asnjë rrezik për mjedisin. Për këtë qëllim, materialet e paketimit janë etiketuar në mënyrë të përshtatshme.



Simboli në produkt ose në ambalazhin e tij tregon se produkti nuk duhet të trajtohet si mbeturinë normale shtëpiake. Çojeni produktin në një qendër të autorizuar grumbullimi për përpunimin e mbeturinave të pajisjeve elektrike dhe elektronike.

Kur ta **hidhni** makinën larëse në fund të jetës së përdorimit të saj, hiqini të gjitha kabllot elektrike, prishini shulat dhe çelësat e derës për të mos e lejuar mbylljen ose bllokimin e derës (siguria e fëmijëve).

Hedhja e rregullt e produktit do të ndihmojë në parandalimin e të gjitha efekteve negative në mjedis dhe në shëndetin e njerëzve, të cilat mund të ndodhin në rast të heqjes së parregullt të produktit. Për informacion të detajuar mbi heqjen dhe përpunimin e produktit, ju lutemi të kontaktoni organin përkatës bashkiak, përgjegjës për menaxhimin e mbeturinave, shërbimin tuaj të hedhjes së mbeturinave ose dyqanin ku keni blerë produktin.

KOHËZGJATJA E PROGRAMIT DHE TABELA E NORMËS SË RROTULLIMEVE

Programet		Temp. [°C]	NORMALCARE (KUJDES NORMAL) (cilësim bazë/i paracaktuar)	SPIN (NORMA E CENTRIFUGIMIT)
			Koha e larjes [në minuta]	[rpm] (xhiro në minutë)
	Cotton black (Pambuk i zi)	40	62	** 1000
		30	59	
	Cotton color (Pambuk me ngjyra)	60	182	* 1200
		40	192	
		30	106	
		20	97	
		--	94	
	Cotton white (Pambuk i bardhë)	90	200	* 1200
		60	174	
		40	184	
	Mix (Të përziera) (Rroba të përziera/ Sintetike)	60	129	** 1000
		40	117	
		30	114	
		20	63	
		--	59	
	Wool/Handwash (Leshi/Larja me dorë)	40	50	** 800
		30	49	
		--	37	
	Speed 20' (I shpejtë 20')	30	20	** 1000
	Power 59' (Fuqia 59')	40	59	** 1200

* Norma e rrotullimeve (centrifugës) mund të ndryshohet dhe norma e re mund të vendoset deri në normën maksimale

** Në varësi të modelit

□ Program standard

-- Larje me ujë të ftohtë

Programet	Temp. [°C]	NORMALCARE (KUJDES NORMAL) (cilësim bazë/i paracaktuar)	SPIN (NORMA E CENTRIFUGIMIT)
		Koha e larjes [në minuta]	[rpm] (xhiro në minutë)
 Steril tub (Sterilizim kazani/ Programi i vetëpastrimit)	--	112	-
 Rinse/Softening (Shpërlarja/Zbutja) (Program i pjesshëm)	--	32	* 1200
 Spin/Drain (Rrotullimet/Centrifuga) (Norma e rrotullimeve/ Shkarkimi) (Program i pjesshëm)	--	17	* 1200
 Sports (Sportive) (Veshje sportive)	40	41	** 1000
	30	39	
 Eco 40-60	-	175	* 1200
 Allergy care (Kujdes ndaj alergjive)	90	143	* 800
	60	118	
	40	98	
 Auto wash (Larje automatike)	30	93	* 1200

* Norma e rrotullimeve (centrifugës) mund të ndryshohet dhe norma e re mund të vendoset deri në normën maksimale

** Në varësi të modelit

□ Program standard

-- Larje me ujë të ftohtë

⚠ Temperatura e ulët e ujit, tensioni i ulët i rrjetit elektrik dhe ngarkesat e ndryshme të larjes mund të ndikojnë në kohën e larjes; koha e mbetur që shfaqet rregullohet sipas rrethanave gjatë procesit të larjes.

⚠ Për shkak të devijimeve në lidhje me llojin dhe sasinë e rrobave, rrotullimeve, luhatjet e furnizimit me energji elektrike, temperaturës dhe lagështisë së mjedisit, kohëzgjatja e programit dhe vlerat e konsumit të energjisë, të matura në përdoruesin përfundimtar mund të ndryshojnë nga ato të paraqitura në tabelë.

MODALITETI I GATISHMËRISË SË ULËT

Në rast se nuk keni aktivizuar asnjë program ose nuk keni zgjedhur asnjë cilësim pas ndezjes së makinës larëse (butoni (1) **NDEZJES/FIKJES/RIFILLIMIT**), pas 5 minutash, njësia e ekranit do të fiket dhe do të kalojë në modalitetin e gatishmërisë për të kursyer energji.

Njësia e ekranit do të riaktivizohet në qoftë se rrotulloni çelësin e përzgjedhjes së programit (2) ose shtypni butonin (1) **NDEZJES/FIKJES/RIFILLIMIT**. Në disa modele, do të ndizet edhe drita brenda kazanit të makinës larëse. Në qoftë se nuk bëni asgjë për 5 minuta pas përfundimit të një programi, njësia e ekranit dhe drita në kazan do të fiken për të kursyer energji.

P_o = energjia mesatare kur është e fikur [W]	< 0,5
P_I = energjia mesatare kur është në gatishmëri [W]	< 0,5
T_I = koha e gatishmërisë [min]	5,00

Ne rezervojmë të drejtën për çfarëdo ndryshim dhe gabime në udhëzimet e përdorimit.

